

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6098
E enjte, 27 gusht 2020
çmimi 0.40 €

Qeveria e Kosovës miraton planin për fillimin e vitit të ri shkollor



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", NASIM HARADINAJ | F. 4-5

S'KA ARSYE T'I VAZHDOHET MANDATI GJYKATËS SPECIALE



Nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Nasim Haradinaj, ka ftuar deputetët e Kuvendit të Kosovës që mos ta përkrahin vazhdimin e mandatit të Gjykatës Speciale. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se nuk ka asnjë arsye që kësaj gjykate t'i vazhdohet mandati. Haradinaj ka deklaruar se për këta pesë vjet Gjykata Speciale ka treguar se nuk ka prova për të ngritur aktakuza ndaj ish-pjesëtarëve të UÇK-së. Sipas tij, Gjykatës Speciale tashmë i ka kaluar mandati. "Nëse presidenti dëshiron t'ia zgjasë mandatin Gjykatës Speciale, duhet t'i mbledhë 80 deputetë. Thaçi duhet ta dijë se më nuk i ka ata deputetë që i kishte dikur", ka thënë Nasim Haradinaj

HYN NË FUQI LIGJI PËR PANDEMINË, GJOBAT DERI NË 2 000 EURO



Ligj për Pandeminë përcakton përgjegjësitë dhe rolin e institucioneve shtetërore, institucioneve shëndetësore publike, private dhe publiko-private për marrjen e masave për parandalimin, kontrollin, trajtimin, monitorimin, sigurimin e financimit dhe ndarjen e përgjegjësisë gjatë pandemisë Covid-19. Ky ligj ka përcaktuar edhe gjoba që fillojnë nga 35, 200 e 500 euro për persona fizikë dhe juridikë e që shkojnë deri në 2 000 euro për persona përgjegjës të personit juridik dhe ndalimin e aktivitetit në rast të moszbatimit të vendimeve të organeve kompetente | F. 3

Hoti: Kam kërkuar nga opozita ta dërgojë një përfaqësues për takimin në Shtëpinë e Bardhë



OPINION

UÇK-ja KISHTE UNITET TË ÇELIKTË (37) F. 11

Shkruan:
Kudusi LAMA



BISEDIMET ME SERBINË, PËRPARIM APO PRAPAKTHIM?! F. 8

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



AKTUALE

LV-ja THOTË SE MARRËVESHJA E DEMARKACIONIT ME MALIN E ZI ËSHTË PARAPËRGATITJE PËR NDARJE TË KOSOVËS F. 2

EKONOMI

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA QË ÇON PËRPARA REALIZIMIN E PROJEKTEVE TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË F. 9

MBAHET PUNËTORIA 'RIMËKËMBJA E TELEKOMIT' F. 9

SPORT

GJILANI S'KA FRIKË NGA APOEL-i, KËRKON KUALIFIKIMIN F. 6



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ballkani Perëndimor do të mund ta sigurojë si donacion vaksinën kundër Covid-19

BRUKSEL, 26 GUSHT - Vendet e Ballkanit Perëndimor do të mund ta sigurojnë vaksinën potenciale kundër koronavirusit edhe përmes donacioneve apo marrëveshjeve bilaterale me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Kjo u konfirmua në selinë e Komisionit Evropian në Bruksel, pasi tashmë janë bërë disa marrëveshje paraprake me prodhuesit e vaksinës për ta siguruar atë për të gjithë qytetarët e BE-së. Me këto marrëveshje, Komisioni Evropian, në emër të shteteve anëtare, ka porositur më shumë se 1 miliard doza të vaksinës potenciale. Krahas kësaj, shtetet anëtare janë duke bërë marrëveshje edhe me prodhuesit potencialë të vaksinës.

cioneve apo marrëveshjeve bilaterale me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Kjo u konfirmua në selinë e Komisionit Evropian në Bruksel, pasi tashmë janë bërë disa marrëveshje paraprake me prodhuesit e vaksinës për ta siguruar atë për të gjithë qytetarët e BE-së. Me këto marrëveshje, Komisioni Evropian, në emër të shteteve anëtare, ka porositur më shumë se 1 miliard doza të vaksinës potenciale. Krahas kësaj, shtetet anëtare janë duke bërë marrëveshje edhe me prodhuesit potencialë të vaksinës.

Bruksel, pasi tashmë janë bërë disa marrëveshje paraprake me prodhuesit e vaksinës për ta siguruar atë për të gjithë qytetarët e BE-së. Me këto marrëveshje, Komisioni Evropian, në emër të shteteve anëtare, ka porositur më shumë se 1 miliard doza të vaksinës potenciale. Krahas kësaj, shtetet anëtare janë duke bërë marrëveshje edhe me prodhuesit potencialë të vaksinës.

së. Me këto marrëveshje, Komisioni Evropian, në emër të shteteve anëtare, ka porositur më shumë se 1 miliard doza të vaksinës potenciale. Krahas kësaj, shtetet anëtare janë duke bërë marrëveshje edhe me prodhuesit potencialë të vaksinës.

potenciale. Krahas kësaj, shtetet anëtare janë duke bërë marrëveshje edhe me prodhuesit potencialë të vaksinës.

BE-ja: Presim që Kosova ta respektojë ligjin dhe Kushtetutën për mandatin e Gjykatës Speciale



paraprakisht nëse ndryshimi i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kushtetutë.

Nëse ky propozim arrin te deputetët, ai duhet të miratohet me 2/3 e votave në kuvend, apo 80 vota. Në Gjykatën Speciale në Hagë nuk kanë dashur ta komentojnë veprimin e presidentit lidhur me vazhdimin e mandatin të gjykatës.

Mirëpo, në fund të vitit të kaluar, në pyetjen e Radios Evropa e Lirë lidhur me atë se a do të duhen institucionet e Kosovës të vendosin për vazhdimin e mandatin të gjykatës, zyrtarët në Hagë kanë thënë se "për vazhdimin e mandatin nuk janë të nevojshme formalitetet ose veprimet specifike".

Ata kanë konsideruar se "ashtu siç e parasheh ligji [për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare ndërmjet Kosovës dhe BE-së], i cili është ratifikuar në Kuvendin e Kosovës, mandati i gjykatës do të vazhdohet derisa Këshilli i Bashkimit Evropian të mos e informojë Kosovën se të gjitha hetimet dhe të gjitha proceset në kuadër të Dhomave të Specializuara kanë përfunduar". Gjykata Speciale heton krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të kryera ndaj pakicave etnike dhe rivalëve politikë, të cilat përmenden në raportin e Këshillit të Evropës në vitin 2011, autor i të cilit është senatori zviceran Dick Marty. Gjykata financon kryesisht nga Bashkimi Evropian dhe është formuar me insistimin e bashkësisë ndërkombëtare.

PRISHTINE, 26 GUSHT - Bashkimi Evropian pret që autoritetet e Kosovës të vazhdojnë të jenë të përkushtuara për sundim të ligjit dhe për mandatin e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar (Gjykata Speciale në Hagë), deklaroi për Radion Evropa e Lirë, Nabila Massrali, zëdhënëse e BE-së për Çështje të Jashtme dhe Siguri. "Këtu përfshihet respektimi i të gjitha dispozitave në ligj dhe Kushtetutë, që në mënyrë të qartë e përcaktojnë mandatin dhe punën e Gjykatës Speciale të Kosovës", ka thënë ajo. Massrali i ka bërë këto deklarata si përgjigje ndaj pyetjes se si e komenton BE-ja

propozimin e presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, lidhur me ndryshimin e Kushtetutës për zgjatjen e mandatin të Gjykatës Speciale.

Sipas propozimit të Thaçit drejtuar Kuvendit të Kosovës më 24 gusht, mandati i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar "do të zgjasë deri kur njoftimi i përfundimit të mandatin të bëhet nga Këshilli i Bashkimit Evropian, në konsultim me Qeverinë e Republikës së Kosovës".

Bazuar në amendamentin e Kushtetutës së Kosovës të 3 gushtit 2015, mandati i gjykatës "do të zgjasë në periudhën prej pesë vjetësh, përveç nëse

lajmërimi për përfundimin e mandatin bëhet më herët, në përputhje me Ligjin për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian".

Paragrafi pasues thekson që në mungesë të njoftimit për përfundim të mandatin, mandati do të vazhdojë deri në njoftimin për përfundim të mandatin, që do të publikohet në përputhje me të njëjtin ligj dhe në konsultim me qeverinë. Megjithatë, në Ligjin për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian thuhet se mandati i kësaj gjykate do të përfundojë

atëherë kur Këshilli i Bashkimit Evropian do t'i lajmërojë për këtë institucionet e Kosovës - gjë që konfirmohet edhe në këtë gjykatë.

Sipas Kushtetutës, ndryshimet kushtetuese mund t'i propozojnë qeveria, presidenti ose një e katërta e deputetëve të Kuvendit, dhe çdo ndryshim kërkon miratimin e dy të tretave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dy të tretat nga radhët e komuniteteve. Po ashtu, Kushtetuta parasheh që ndryshimet mund të miratohen nga Kuvendi vetëm pasi ta ketë adresuar kryetari i Kuvendit të Kosovës amendamentin e propozuar në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar

Viti shkollor në Maqedoninë e Veriut shtyhet për tetor

SHKUP, 26 GUSHT - Viti i ri shkollor në Maqedoninë e Veriut nuk do të fillojë më 1 shtator, siç është paralajmëruar më herët, por me

një muaj vonesë, më 1 tetor. Kështu ka bërë me dije i emëruari për kryeministër i këtij vendi, Zoran Zaev. "Viti shkollor nuk do të fillojë më

1 shtator. Për shkak të përgatitjes së protokolleve shëndetësore, mësimi duhet të nisë më 1 tetor. Vendimi do të merret në seancën e

parë të qeverisë, në të cilën do të miratohen edhe ndryshimet ligjore për mbarëvajtjen e procesit mësimor", ka thënë Zaevi

gjatë dorëzimit në Kuvend të përbërjes së re të qeverisë, e cila, siç bëhet me dije, do të votohet deri në fund të javës.

Bie numri i viktimave nga Covid-19 në Kosovë

Edhe katër viktima dhe 157 raste të reja me Covid-19

Gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë janë regjistruar katër viktima nga Covid-19. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 154 pacientë dhe janë shënuar 157 raste të reja me Covid-19

“Epoka e re”

PRISHTINË, 26 GUSHT - Në Kosovë të mërkurën janë konfirmuar edhe 157 raste të reja me Covid-19 dhe katër viktima. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 154 pacientë. “Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR dhe në laboratorët private, janë testuar gjithsej 511 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 157 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 4 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Numri total i rasteve pozitive është 12 840 raste nga 48 743 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 492 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 154 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 8 942 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 406”, është thënë në njoftimin e IKShPK-së.

Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 52 raste, komuna Gjilan 15 raste, komuna Gjakovë 12 raste, komuna Prizren 12 raste, komuna Vushtrri 11 raste, komuna Ferizaj 7 raste,

komuna Malishevë 6 raste, komuna Fushë Kosovë 5 raste, komuna Podujevë 5 raste, komuna Kamenicë 4 raste, komuna Mitrovicë 4 raste, komuna Drenas 3 raste, komuna Dragash 2 raste, komuna Lipjan 2 raste, komuna Obiliq 2 raste, komuna Pejë 2 raste, komuna Rahovec 2 raste, komuna Shtime 2 raste, komuna Suharekë 2 raste, komuna Viti 2 raste dhe me nga një rast komunat Deçan, Graçanicë, Kaçanik, Skenderaj dhe Zubin Potok.

Rreth 400 pacientë me koronavirus të shtrirë në spitalet e Kosovës

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar të mërkurën se në Qendrën Klinike Universitare dhe në spitalet rajonale të Kosovës janë të shtrirë gjithsej 499 pacientë. Prej këtyre, 393 pacientë janë të prekur me Covid-19. Në njoftimin e ShSKUK-së është thënë se 11 pacientë janë të vendosur në respiratorë, 29 në makinat e frymëmarrjes CPAP, ndërsa 332 të tjerë po trajtohen me oksigjenoterapi. Qendra Klinike Universitare e Kosovës dhe spitalet rajonale kanë kapacitet prej 700 shtetërisht për pacientë.



USAID-i i dhuron Kosovës termo-skanerë

USAID-i, përmes OBSH-së në Kosovë, i ka dhuruar termo-skanerë për ta ndihmuar personelin shëndetësor që vepron në aeroport dhe pika kufitare. Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se këto pajisje do t'i shërbejnë personelit shëndetësor që vepron në pikat e frekuentuara nga qytetarët siç është aeroporti dhe pikat e tjera kufitare. Ai ka deklaruar se Ministria e Shëndetësisë dhe Qeveria e

Kosovës në vazhdimësi do të përpiqen për të siguruar kushte sa më të mira për stafin shëndetësor. “E inkurajoj personelin shëndetësor që pajisjet e siguruar nga miqtë tanë, USAID-i përmes OBSH-së, të përdoren në mënyrën më të drejtë dhe t'i shërbejnë qëllimit fisnik të donatorëve. Ministria e Shëndetësisë dhe Qeveria e Kosovës në vazhdimësi do të përpiqen të sigurojnë kushte sa më të mira për

punë e mirëqenie për stafin shëndetësor dhe shërbime sa më cilësore dhe të sigurta për qytetarët e vendit”, ka thënë Zemaj. Kjo nuk është ndihma e vetme nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pasi që më parë ishin dhuruar pajisje mbrojtëse profesionale për personelin shëndetësor, në kuadër të Programit të Ndihmës Humanitare nga Komanda Evropiane e ShBA-së.

Hoti: Kam kërkuar nga opozita ta dërgojë një përfaqësues për takimin në Shtëpinë e Bardhë



PRISHTINË, 26 GUSHT - Kryeministri i vendit, Avdullah Hoti, në një konferencë për media mbajtur të mërkurën, ka thënë se kanë një pajtim me partnerët e koalicionit qeverisës për takimin e së enjtes në Bruksel. Ai ka thënë se në takimin në Bruksel do të flitet për fazën e njohjes finale. “Ju e dini se kemi një pajtim me partnerët e koalicionit, që dialogun e bëjmë për njohje reciproke. Nesër diskutimet janë në fazën për njohje finale. Nesër do të diskutojmë për çështje ekonomike”, ka thënë Hoti. Po ashtu, kryeministri Hoti

është pyetur edhe për delegacionin e Kosovës që do të udhëtojë për në ShBA. Me këtë rast, ai tha se është duke u finalizuar edhe delegacioni që do të marrë pjesë atje, i cili kryesohet nga kryeministri, në bazë të kompetencave kushtetuese që ka. Me këtë rast, kryeministri Hoti tha se do të tentojë që në delegacion të përfshihen të gjithë, pa përjashtim, sepse kjo çështje është e rëndësishme më të lartë shtetërore, një takim që është pritur tash e sa kohë në Shtëpinë e Bardhë. “Unë sot kam dërguar letër edhe te partitë opozitare që t'i

propozojnë përfaqësuesit e tyre në këtë delegacion të Qeverisë së Kosovës në takimin në Shtëpinë e Bardhë, pastaj në takimin e ardhshëm të paraparë në fillim të shtatorit në Bruksel”, ka treguar kryeministri Hoti, duke shtuar se është i hapur për të krijuar një ekip gjithëpërfshirës të të gjitha forcave politike pa përjashtim, duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj teme, por duke mos i bartur kompetencat kushtetuese, por duke i ushtruar ato ashtu siç janë të parapara në Kushtetutë.



Flet për “Epokën e re”, Nasim Haradinaj

S’KA ARSYE T’I VAZHDOHET MANDATI GJYKATËS SPECIALE

Nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Nasim Haradinaj, ka ftuar deputetët e Kuvendit të Kosovës që mos ta përkrahin vazhdimin e mandatit të Gjykatës Speciale. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se nuk ka asnjë arsye që kësaj gjykate t’i vazhdohet mandati. Haradinaj ka deklaruar se për këta pesë vjet Gjykata Speciale ka treguar se nuk ka prova për të ngritur aktakuza ndaj ish-pjesëtarëve të UÇK-së. Sipas tij, Gjykatës Speciale tashmë i ka kaluar mandati. “Nëse presidenti dëshiron t’ia zgjasë mandatin Gjykatës Speciale, duhet t’i mbledhë 80 deputetë. Thaçi duhet ta dijë se më nuk i ka ata deputetë që i kishte dikur”, ka thënë Nasim Haradinaj

kundërshtim me të drejtat e njeriut.

Më tej, Haradinaj ka thënë se nuk beson se do të mund të mbledhen 80 deputetë për t’ia vazhduar mandatin kësaj gjykate. “Presidenti Thaçi duhet ta dijë se më nuk i ka ata deputetë që i kishte dikur”, është shprehur Haradinaj.

“Epoka e re”: Z. Haradinaj, presidenti Hashim Thaçi i ka propozuar Kuvendit të Kosovës zgjatjen e mandatit të Gjykatës Speciale. Si e keni parë kërkesën e presidentit?

Haradinaj: Presidenti i di arsyet e veta pse ka bërë një propozim të tillë. Nuk dua të spekuloj se ka presion për këtë çështje. Por ajo që dihet është se tash së fundi është shtuar një presion publik ndërkombëtar ndaj presidentit dhe Kosovës. Kjo u pa edhe me bërjen publike të atyre propozim-aktakuzave ndaj presidentit Hashim Thaçi dhe liderit të PDK-së, Kadri Veseli.

Për Organizatën e Veteranëve të Luftës UÇK-së kjo është një kërkesë jovalide. Ne jemi katërçipërisht kundër kësaj kërkesë dhe nuk pajtohemi në asnjë mënyrë. Përkundrazi, mendoj se presidenti është dashur të mësojë nga gabimet e veta në të kaluarën, që u ka besuar ndërkombëtarëve, të cilët i kanë premtuar se do ta ndërtojnë një gjykatë të paanshme. Pra, e kanë mashtruar. Në fakt, ata ndërtuan një gjykatë të njëanshme dhe të padrejtë ndaj shqiptarëve dhe UÇK-së.

“Epoka e re”: Pra, ju mendoni se publikimi i propozim-aktakuzave ndaj Thaçit dhe Veselit ka lidhje me vazhdimin e mandatit për Specialen?

Haradinaj: Për mua ky ka qenë një presion i përgjithshëm për presidentin dhe për të gjithë në të tjerët. Mirëpo kësaj radhe mendoj se deputetët duhet të jenë të matur dhe t’i marrin

EPOKA E RE **Muhamet KOÇI**

PRISHTINË, 26 GUSHT - Nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Nasim Haradinaj, ka deklaruar se nuk ka arsye që Gjykatës Speciale t’i vazhdohet mandati ashtu siç ka kërkuar presidenti i vendit, Hashim Thaçi. Ai ka thënë se nuk i di arsyet pse presidenti ka bërë një gjë të tillë, por është kundër këtij propozimi. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka

e re”, ai ka ftuar deputetët e Kuvendit të Kosovës që të mos ia vazhdojnë mandatin kësaj gjykate.

Nasim Haradinaj ka deklaruar se për këta pesë vjet kjo gjykatë ka treguar se nuk ka prova për të ngritur aktakuza ndaj ish-pjesëtarëve të UÇK-së. Sipas tij, kjo gjykatë i ka pastruar pretendimet për krime. “Kjo gjykatë ka dështuar të ngritë aktakuza, ani pse ka punuar për të mbledhur materiale për akuza, por nuk ia ka arritur

qëllimit sepse nuk ka pasur prova. Në njëfarë mënyre kjo gjykatë na ka pastruar, sepse pretendimet e tyre kanë qenë të pabazuar. Kjo gjykatë e ka kryer punën e vet dhe ka dëshmuar se nuk ka prova për pretendimet e ngritura. Tashmë ka përfunduar afati i saj. Gjykata Speciale nuk ekziston më”, ka thënë Haradinaj, duke shtuar se Gjykatës Speciale i ka mbaruar mandati nga 3 gushti. Sipas tij, kushdo që pretendon se kjo gjykatë ka mandat, është në



parasysh projekt-propozimet e organizatës tonë që i kemi dërguar në Kuvend.

“Epoka e re”: Çfarë po kërkoni tani?

Haradinaj: Ne më nuk e kërkojmë zhbërjen e kësaj gjykate, sepse Gjykata Speciale tashmë është vetëzhabë. Ajo e ka shpenzuar veten duke e kaluar mandatin pesëvjeçar. Për këto vite nuk ka mundur të gjejë asnjë material për ngritje të aktakuzës. Mendojmë se Specialja ka pranuar se nuk ka pasur material për aktakuzë. Pra, ai ligj ka rënë poshtë dhe nga 3 gushti nuk ekziston de fakto, por as de juro. Gjykatës Speciale i ka kaluar mandati. Andaj më nuk kemi se çfarë të zhbëjmë. Nëse presidenti thotë se duhet t'i vazhdohet mandati kësaj gjykate, ai duhet ta dijë se për t'ia vazhduar mandatin kësaj gjykate i duhet që t'i sigurojë edhe një herë dy të tretat e votave në Kuvend. Pra, i duhet edhe një herë për t'u mashtruar presidenti nga të huajt sikurse e kanë mashtruar herën e parë.

“Epoka e re”: Çfarë do të thotë për OVKUÇK-në fakti se kjo gjykatë për pesë vjet nuk ka ngritur zyrtarisht ende asnjë aktakuzë?

Haradinaj: Kjo gjykatë ka dështuar të ngrehë aktakuzë ani pse ka punuar për të mbledhur materiale për akuzë, por nuk ia ka arritur qëllimit sepse nuk ka pasur prova. Në njëfarë mënyre kjo gjykatë na ka pastruar, sepse pretendimet e tyre kanë qenë të

pabazuara. Kjo gjykatë e ka kryer punën e vet dhe ka dëshmuar se nuk ka prova për pretendimet e ngritura. Tashmë ka përfunduar afati i saj. Gjykata Speciale më nuk ekziston. Në fund po del ajo që ka thënë qysh në fillim të procesit OVL-UÇK-ja. Kjo gjykatë është politike dhe pretendimet e saj nuk i ka të bazuara. Ndoshta Specialja mund të thotë se ende nuk i ka përfunduar rastet që i ka hetuar, mirëpo çdo ftesë e re që bëhet për pjesëtarët e UÇK-së jashtë këtij afati, mendoj se bie në kundërshtim me ligjet e Kosovës dhe të drejtat e njeriut.

“Epoka e re”: A do të thotë kjo se më nuk ka arsye që t'i zgjatet mandati kësaj gjykate?

Haradinaj: Natyrisht se nuk ka arsye. Kjo gjykatë nuk ka qenë e përjetshme. Gjykatës Speciale i është caktuar një mandat brenda të cilit mund t'i hetojë krimet e pretenduara. Tash pse t'i zgjatet mandati?! Me vetë faktin se kjo gjykatë nuk ka gjetur materiale për të ngritur aktakuzë, sepse nuk e lë për qejf këtë çështje, ajo është devaluuar. U dëshmuar se është puropolike dhe u dëshmuar se pa bazë është ngritur kjo gjykatë.

“Epoka e re”: Por presidenti po thotë se ka arsye?

Haradinaj: Ne i kemi dërguar propozimet tona në Kuvend për t'i vendosur para aktit të kryer deputetët të cilët e kanë ditur se kjo gjykatë është kundër shqiptarëve por, megjithatë, e kanë votuar. Tash t'i shohim veprimet e tyre. Nëse presidenti dëshiron t'ia zgjasë mandatin Gjykatës Speciale, duhet t'i mbledhë 80 deputetë.

“Epoka e re”: A besoni se do të mund të binden 80 deputetë përsëri për t'ia vazhduar mandatin Speciales?

Haradinaj: Presidenti Thaçi duhet ta dijë se më nuk i ka ata deputetë që i kishte dikur. Më nuk i ka deputetët e dëgjueshëm, sepse ata tanimë janë vetëdijuesuar dhe e kanë parë se çfarë gabimi kanë bërë atëherë kur është votuar kjo gjykatë. Në propozimet tona që i kemi dorëzuar në Kuvend kemi thënë se nëse duan t'ia vazhdojnë mandatin kësaj gjykate, atëherë duhet të ndiqen të gjitha krimet që janë bërë në Kosovë, pa marrë parasysh nacionalitetin. Kjo gjykatë duhet ta ketë preambulën e gjykatës së Kosovës. Arkivat e Gjykatës Speciale të kthehen në Kosovë dhe ato të ruhen e të mos demolojnë. Dhe në fund, kemi kërkuar që kjo gjykatë të mbikëqyret dhe të monitorohet nga një komision. Mirëpo, ne një herë i kemi dhanë shansin kësaj gjykate, duke e lejuar me Kushtetutë dhe ligje. Tash mendoj se bien ndesh me Kushtetutën ata të cilët mendojnë se ka mandat kjo gjykatë.

Qeveria e Kosovës miraton planin për fillimin e vitit të ri shkollor

Qeveria e Kosovës ka miratuar planin e Ministrisë së Arsimit dhe Teknologjisë për fillimin e vitit të ri shkollor parauniversitar në kohën e pandemisë së koronavirusit. Në bazë të këtij plani parashihet që mësimi të zhvillohet në tre skenarë: kthimi në shkollë, mësimi i kombinuar dhe mësimi në distancë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 GUSHT - Qeveria e Kosovës, e drejtuar nga kryeministri Avdullah Hoti, ka zhvilluar të mërkurën mbledhjen e 27-të, të rregullt, në të cilën ka shqyrtuar dhe ka miratuar vendimin për përkrahjen institucionale dhe financiare për fillimin dhe realizimin e suksesshëm të vitit shkollor 2020-2021. Vendimi i miratuar në mbledhjen e qeverisë është bërë sipas kërkesës së Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për përkrahje institucionale dhe financiare për fillimin dhe realizimin e suksesshëm të viti shkollor 2020-2021.

Mjetet e nevojshme janë llogaritur në vlerë prej 9,515,384 eurosh.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka paraparë format e mësimi në shkollë dhe e-mësimi, të cilat do të zbatohen në nivele dhe shërbime të ndryshme të arsimit parauniversitar dhe të cilat do të aplikohen varësisht nga skenari për të cilin do të përcaktohen autoritetet e Kosovës për zhvillimin e mësimi gjatë vitit shkollor 2020-2021.

Mësimi online dhe në distancë do të zhvillohet dhe publikohet paralelisht me aplikimin e skenarëve të ndryshëm për të qenë në dispozicion të të gjithë nxënësve në Kosovë edhe si formë rezervë në rastet e situatave të paparashikuara.

Kabineti qeveritar ka miratuar edhe Master-Planin e projektit për mësimin 2020, i cili shqyrtonte të gjitha format dhe mundësitë e organizimit të mësimi në vitin shkollor 2020-2021. Dokumenti prezanton tre skenarë të ndryshëm, të mund-

shëm për organizimin e mësimi, sipas kushteve dhe situatave të ndryshme në institucionet e arsimit parauniversitar në Kosovë: a) Organizimi i mësimi në shkollë kërkon investime në pastërti, mirëmbajtje dhe dezinfektim të shkollave; b) Mësimi i kombinuar (mësimi në shkollë dhe mësimi në distancë) kërkon investim në pastërti, mirëmbajtje dhe dezinfektim. Kërkon angazhimin e stafit ndihmës-rezervë duke përfshirë mësues, punëtorë teknikë, mjekë dhe psikologë. Ky opsion kërkon që njëkohësisht të zhvillohet edhe mësimi online; c) Mësimi online dhe në distancë, ky opsion kërkon sigurimin dhe blerjen e pajisjeve teknologjike dhe zhvillimin e mësimi online.

Pas mbledhjes së qeverisë, kryeministri Avdullah Hoti bashkë me ministrin e Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, kanë mbajtur konferencë për media. Hoti ka thënë se në dokumentin e miratuar janë dhënë shumë qartë udhëzimet se si dhe kur hapen shkollat, kriteret që duhet të përmbushen për hapjen e shkollave, kriteret për organizimin dhe procedurat që duhet të ndiqen për organizimin e mësimi online, i cili do të jetë i plotë, si një platformë shtesë për nxënësit. Siç tha kryeministri, është me rëndësi të thuhet se mësimi do të organizohet edhe në gjuhët e komuniteteve për të mos mbetur mbrapa asnjë nxënës në tërë Kosovën. “Falënderoj IKShPK-në dhe MSh-në që kanë punuar ngushtë gjatë kësaj kohe me ministrin e Arsimit dhe Shkencës për t'i zhvilluar protokollin e nevojshme që duhet t'i ndjekin arsimtarët në klasë, kujdestari i klasës, shkollë dhe

komuna në rast se paraqiten raste të infektiveve nëpër shkollë”, ka deklaruar kryeministri Hoti, duke shtuar se janë bërë përgatitje të nevojshme për një fushatë informuese të nxënësve, për masat që duhet të respektohen, për organizimin e mësimi duke vendosur shenja dalluese nëpër shkollë dhe nëpër klasa për nxënësit. “Jemi të vetëdijshëm se po e marrim përsipër një risk për t'i hapur shkollat sipas procedurave që duhet të ndiqen në kushtet e pandemisë, andaj kërkohet kujdes ekstrem i prindërve, i nxënësve, i arsimtarëve dhe i komunave, që të mos kthehen shkollat në vend ku përhapet virusi”, ka thënë Hoti, i cili u ka bërë thirrje prindërve dhe arsimtarëve që t'i marrin udhëzimet e nevojshme, t'i udhëzojnë fëmijët, nxënësit për respektim të plotë të masave që janë përcaktuar nga ministri i Arsimit.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, ka thënë se në kuadër të këtij Master-Plani janë konceptet për realizimin e mësimi për secilin nivel të sistemit arsimor, janë paraqitur skenarët dhe fazat se si do të fillojë viti i ri shkollor, po ashtu janë përshkruar edhe përgjegjësitë e secilit institucion të përfshirë. Sipas planit të Ministrisë së Arsimit, viti shkollor do të nisë në fazë.

E para pritet të nisë më 1 shtator dhe përfshin parashkollorët, klasat e para, të dyta, të treta, të gjashta dhe të dhjeta. Faza e dytë do të fillojë më 7 shtator dhe përfshin klasat e katërta dhe të pesta, ndërsa faza e tretë e mësimi do të fillojë më 10 shtator dhe do t'i përfshijë klasat e shtata, të teta, të nënta, të njëmbëdhjeta dhe të dymbëdhjeta.



LV-ja thotë se marrëveshja e demarkacionit me Malin e Zi është parapërgatitje për ndarje të Kosovës

PRISHTINE, 26 GUSHT - Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Liburn Aliu, ka thënë se marrëveshja e demarkacionit me Malin e Zi është "parapërgatitje për ndarje të Kosovës". Këtë deklaratë Aliu e dha në një konferencë për media në përvjetorin e pestë të kësaj marrëveshje. "Nënshkrimi i marrëveshjes së 26 gushtit, të vitit 2015 dhe ratifikimi i saj pastaj, e sjell pyetjen logjike për atë që ndodhi në Vjenë më 25 gusht 2018, në konferencë, ku moderatori iu drejtua asokohe presidentit Thaçit se a je i gatshëm të japësh territor për marrëveshje dhe Thaçi tha 'po'. Pra, marrëveshja për t'i dhënë Malit të Zi territor është përgatitje e terrenit për ndarje. Ndarja e iniciuar nga presidenti

Thaçi arsyetohej nga bosnjëzimi dhe rreziku i tij që vinte edhe si rezultat i marrëveshjes së prillit (2013) që ai vetë [Thaçi] e kishte nënshkruar", ka thënë deputeti Liburn Aliu.

Ai ka theksuar se gënjeshtër tjetër që përcolli këtë marrëveshje të dëmshme ishte premtimi për liberalizimin e vizave. "Kartë kjo që u përdor edhe kur u nënshkrua marrëveshja për Zajednicën në vitin 2015. Është kërkuar që të mos miratohet kjo marrëveshje sepse nuk kishte garanci për liberalizim të vizave. Me PAN-in, liberalizimi vetëm sa na u largua edhe më tepër. LV-ja i ka kundërshtuar përherë me të gjitha mundësitë që kishte këto plane. Ne jemi dhe vazhdojmë



të jemi të bindur, se njëjtë si në shekujt e kaluar, edhe më tej vazhdojnë përpjekjet për

rudhje dhe copëtim të territorit të banuar me shumicë shqiptare dhe kjo marrëveshje

ishite inkurajim për vendet e tjera dhe Serbinë", ka thënë Aliu.

Veseli kërkon mobilizim e angazhim më të madh të PDK-së



FUSHË-KOSOVË, 26 GUSHT (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka vizituar të mërkurën degën e partisë në Fushë-Kosovë. Në takim me strukturat drejtuese,

Veseli ka folur për zhvillimet politike, për reformat në parti dhe nevojën për mobilizim dhe angazhim më të madh të partisë. Kryetari i degës, Rrahim Tërnavë, ka falënderuar

kryetarin dhe sekretarin për vizitën, duke e informuar edhe për aktivitetet e fundit dhe situatën e qeverisjes lokale. Një ditë më parë kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri

Veseli, ka qëndruar në Prizren dhe Dragash, ku ka takuar kryesitë e degëve të partisë dhe strukturat udhëheqëse. Edhe në këto takime është diskutuar për organizimin e mëtejshëm në

funkcion të zgjedhjeve të ardhshme lokale.

Veseli ka kërkuar mobilizim sa më të madh për t'ua rikthyer qytetarëve prizrenas besimin në PDK dhe me qeverisje të mirë.


Testi i Maturës do të mbahet duke respektuar masat anti Covid

PRISHTINE, 26 GUSHT (ER) - Testi i Maturës do të mbahet këtë të shtunë, nën masa të shtuara të sigurisë, shkaku i pandemisë Covid-19. Komisioni Shtetëror i Maturës ka bërë me dije se testi i maturantëve do të mbahet në masa të shtuara të kujdesit, në

mënyrë që të ruhet shëndeti i të gjithë pjesëmarrësve në këtë proces. Në ditën e shtunë, kur edhe do të mbahet testi, do t'u ndalohej hyrja në qendrat e testimit të gjithë personave të paautorizuar, kurse mediat do të mund të kenë qasje me

qendrat e testimit deri në orën 9:30.

Testi i Maturës, i cili ishte paraparë të mbahej në muajin maj, me vendim të Ministrisë së Arsimit është shtyrë për në muajin gusht shkaku i pandemisë Covid-19.



Të mërkurën ka hyrë në fuqi Ligji për Pandeminë, i cili është votuar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës

Hyn në fuqi Ligji për Pandeminë, gjobat deri në 2 000 euro



Ligj për Pandeminë përcakton përgjegjësitë dhe rolin e institucioneve shtetërore, institucioneve shëndetësore publike, private dhe publiko-private për marrjen e masave për parandalimin, kontrollin, trajtimin, monitorimin, sigurimin e financimit dhe ndarjen e përgjegjësisë gjatë pandemisë Covid-19. Ky ligj ka përcaktuar edhe gjoba që fillojnë nga 35, 200 e 500 euro për persona fizikë dhe juridikë e që shkojnë deri në 2 000 euro për persona përgjegjës të personit juridik dhe ndalimin të aktivitetit në rast të moszbatimit të vendimeve të organeve kompetente

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 GUSHT - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka falënderuar deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe të gjitha palët e përfshira për kontributin e dhënë për miratimin e Ligjit Nr. 07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19, i cili qëllim kryesor ka krijimin e bazës ligjore për institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19. Ky ligj, i cili përcakton përgjegjësitë dhe rolin e institu-

cioneve shtetërore, institucioneve shëndetësore publike, private dhe publiko-private për marrjen e masave për parandalimin, kontrollin, trajtimin, monitorimin, sigurimin e financimit dhe ndarjen e përgjegjësisë gjatë pandemisë Covid-19, do të jetë një instrument i mirë në duart e institucioneve dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës, për të adresuar shumë çështje në mënyrë më efektive për menaxhimin e pandemisë Covid-19. Ligj përcakton masat dhe sanksionet të cilat do të ndërmerren ndaj personave fizikë dhe juridikë, shtetas të Republikës së Kosovës apo të huaj, me qën-

drim në Republikën e Kosovës, të cilët i shkelin rregullat, vendimet dhe udhëzimet e nxjerra nga organet kompetente, gjatë gjithë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit, pandemisë të shkaktuar nga Covid-19. Duke e vlerësuar lart kontributin e secilit që ka dhënë kontribut të drejtpërdrejtë në miratimin dhe hyrje në fuqi të këtij ligji, ministri Zemaj ka theksuar se Ministria e Shëndetësisë si bartëse e procesit të menaxhimit të pandemisë Covid-19 do t'i ushtrojë përgjegjësitë e veta në përputhje me autorizimet e posaçme të cilat ia jep ky ligj në funksion të ndërmarrjes së veprimeve për

luftimin dhe pengimin e përhapjes së sëmundjes Covid-19.

Ky ligj i krijon mundësi të mëdha Ministrisë së Shëndetësisë të ndërmarrë masa për parandalimin, menaxhimin dhe kontrollin e sëmundjes, t'i rrisë kapacitetet parandaluese dhe trajtuese përmes metodave të testimit, diagnozës dhe trajtimit; raportimin dhe koordinimin e institucioneve me qëllim të një menaxhimi sa më gjithëpërfshirës të pandemisë Covid-19. Ministri Zemaj e sheh si hap të rëndësishëm të paraparë me ligj kompensimin mbi pagën bazë për punonjësit e institucioneve shtetërore të angazhuar në betejën kundër pandemisë Covid-19 dhe mundësitë e angazhimit në proces edhe të stafit profesional dhe mbështetës për nevojat e tyre urgjente gjatë pandemisë Covid-19, derisa rikujton qytetarët që ky ligj duhet të zbatohet në funksion të mbrojtjes së shëndetit publik.

Ndonëse esenca e ballafaqimit të mirë me Covid-19 është informimi dhe edukimi i popullatës për ta ndryshuar sjelljen përballë infeksionit, ministri Zemaj rikujton se ligji parashih edhe masa ndëshkimore të cilat organet kompetente mund t'i shqiptojnë ndaj atyre që i shkelin masat kundër Covid-19.

Ligji ka përcaktuar edhe gjoba që fillojnë nga 35, 200 e 500 euro për persona fizikë dhe juridikë e që shkojnë deri në 2000 euro për persona përgjegjës të personit juridik dhe ndalim të aktivitetit në rast të moszbatimit të vendimeve të organeve kompetente. Ministri i Shëndetësisë beson që tashmë institucionet dhe qytetarët e vendit e kanë kuptuar se miratimi i këtij ligji është në funksion të mbrojtjes së shëndetit të tyre, mirëqenies sociale dhe ekonomike dhe, si i tillë, do të respektohet për ta ruajtur dhe përparuar shëndetin e popullatës në Republikën e Kosovës.

Komiteti i Gjilanit bën thirrje për parandalimin e përhapjes së Covidit


GJILAN, 26 GUSHT (ER) - Komiteti i Gjilanit për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19, pas 15 rasteve të reja pozitive, ka mbajtur mbledhjen ditore, nën kryesimin e nënkryetarit Arbër Ismajli.

Gjatë takimit nënkryetari Arbër Ismajli u ka bërë thirrje qytetarëve që të kenë kujdes të shtuar për parandalimin e përhapjes së Covid-19, që t'i përdorin maskat, të kenë kujdes në higjienën personale dhe ta

mbajnë distancën. Pasqyra e përballjes me pandeminë Covid-19 në Gjilan është kjo. 794 të infektuar në total, 593 të shëruar, 170 raste aktive, 31 të vdekur, 49 të hospitalizuar dhe 26 mostra në pritje.



Bisedimet me Serbinë, përparim apo prapakthim!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Në vend se bisedimet midis dy shteteve që luftuan, njëra, Serbia, për të ruajtur dhe mbajtur Kosovën si koloni dhe tjetra, Kosova, për ta fituar lirinë si të gjitha vendet e tjera, të jenë vullnet dhe domosdoshmëri e dy shteteve për normalizim të marrëdhënieve, bashkësia ndërkombëtare imponoi bisedimet krejtësisht të pabarabarta duke zbatuar në mënyrë të paskrupullt standarde të dyfishta. Serbia u favorizua në çdo pikëpamje duke u amnistuar nga krimet e bëra në hapësirat e ish-Jugosllavisë, deri në gjenocid. Pala e Kosovës, krejtësisht e papërgatitur për bisedime, pa agjendë kombëtare dhe shtetërore, u detyrua, sipas inercionit të kushtëzuar, të pranojë çdo propozim të ndërkombëtarëve, edhe në rast se e pësoi me humbje të territorit dhe duke e vënë seriozisht në pikëpyetje ekzistencën e vet shtetit. Ndërkombëtarët i vardisen Serbisë duke i bërë lëshime të jashtëzakonshme që nga heqja e embargos për shitje të armëve e

deri te proceset e integritimit në BE që u bënë me një dinamikë të përshpejtuar, kurse Kosovës i imponuan legalizimin e ndërhyrjes së Serbisë në punët e rregullimit të brendshëm të Kosovës përmes Zonave të Mbrojtura dhe Asociacionit të Komunave të Serbisë në Kosovë, ekskluzivisht në baza etnike, duke i dhënë në këtë mënyrë më shumë fuqi në hartimin e infrastrukturës rrugore një popi të stërmbushur me mbushje shoviniste si puna e Sava Janjiqit që është më vendimmarrës se të gjithë ministrat e infrastrukturës së Kosovës. Kosovës ia imponuan Demarkacionin duke i premtuar liberalizim të vizave për t'i shtuar edhe një dry më shumë në kafazin e izolimit absolut ku janë vendosur, jo politikanët e papërgjegjshëm dhe shpërdorues kosovarë por qytetarët e Kosovës. Së fundi, Kosovës i imponua edhe një Gjykatë Speciale për të gjykuar krimet që i ka "bërë" UÇK kurse, në mënyrën më të pështirë u amnistuan kriminelët e luftës së Serbisë Aleksandar Vuçiq, Vojislav Sheshel, Daçiq, Diković etj. e që, në fakt, paraqet racizëm të ndyrë. Tash, Kosovës po i imponohen bisedime biseksuale apo dybinarëshe, në njërin anë duan dhe duket se janë protagonistë kryesorë Borrell dhe Lajçak, me vend pune në Bruksel kurse me mendje dhe bindje në Beograd dhe, në anën tjetër i humburi në iluzionet e madhështisë së

projektuar, arroganti tashmë i tredhur politikisht, Grenell dhe një president në përfundim të mandatit e që për fat të keq për ne do ta ketë edhe një mandat, Donald Tramp që Kosovën po e përdorë dhe keqpërdorë për qëllime elektorale duke imponuar një zgjidhje që do t'i kushtojë subjektivitetit shtetëror të Kosovës dhe forcimit të rolit të Serbisë në Kosovë. Me gjasë duket se Parku me Trëndafila në Shtëpinë e Bardhë keq do të kundërmojë nga mbushja e brekëve të politikanëve tanë!

Ekipi negociator apo Ekipi Shëtitor i Kosovës:

Përfaqësuesit e Kosovës në këto bisedime janë krejtësisht të përçarë, pa ide, pa vizion, pa agjendë dhe me një qëndrim biseksual: brenda dhe para qytetarëve të Kosovës tregojnë muskuj dhe forcë kurse para ndërkombëtarëve i lëshojnë krejtësisht brekët duke ua lënë pjesët më të ndjeshme të trupit në dispozicion. Duke lejuar t'u nëpërkëmbët dhe shkërdhehet nderi! Ekipi Negociator me këtë Qeveri të lodhur fare bëri përpjekje të identifikohet krejtësisht në baza partiake, si Ekip i LDK-së që udhëhiqet nga Avdullah Hoti, me mungesë kronike të karizmës dhe koçeve për venime të mëdha politike dhe Skendës që u nxor nga naftalina e arkivit e që ende është i dehur nga fama e së kaluarës. Aktualisht Kosova po përfaqësohet nga Mohikani i

Fundit në zinxhirin e marrjes së vendimeve të mëdha dhe Aristokrati i Fundit në organizimin fisnor politik të Kosovës. Kemi një opozitë të tredhur në ndërmarrjen e veprimeve opozitare kurse e fortë në sporte orale - retorikë. LV-ja kurrsesi nuk po pajtohet që ëndrra e mbajtjes së pushtetit nuk zgjati as sa një ëndërr e një nate vere, me fajin e saj, pa asnjë dyshim sepse deshi ta promovojë dhe instalojë tarakizmin politik dhe arrogancën ta përligj si standard të pakundërshtueshëm përmes mujsharëve që kanë para dhe analfabeteve roze. Tash po kërkojnë vetëm zgjedhje për të konfirmuar rezultatet e sondazheve në vend se të bashkërendisin veprimet opozitare. E kanë lansuar një ide se Grenelli që duket se është i urryeri nr. 1 i LV-së duhet të refuzohet sikur dikur Gelbarti duke kërkuar një Holbruk të ri, kurrë mos u ktheftë duke injoruar faktin se nuk pati kundërshtim të organizuar ndaj Gelbartit por se pati sakrificim individual dhe personal të vendosur të të Pavdekshmit Baca Adem Demaçit që nuk pranoi cilësimin e Gelbartit se UÇK qenka organizatë terroriste duke këmbëngulur, deri në vetëmohim se UÇK është ushtri çlirimtare. Në mungesë fizike të Bacës Adem, dhe në mungesë të respektit për veprën dhe sakrificën e Bacës, nga vrimat e rehatisë personale,

kanë dalë minjtë e vegjël dhe të mëdhenj duke veshur lëkuren e luanit, me pretendime se nga ata varet, jo vetëm Kosova por edhe fati i botës. PDK shumë mirë e nisi itinerarin opozitar për t'u shndërruar së fundi në parti të Behgjet Pacollit, as mish e as peshk ku zëdhënësi mëton ta ketë rolin më të madh se vet kryetari i partisë. Nuk ka kuptim ta kritikoni pozitën, ta quani mashtruese e në anën tjetër ta përkrahni dhe votoni çdo propozim të pozitës! Në PDK janë dy rryma; ata që kanë mbetur jashtë sistemit dhe që po e presin rastin për kthim nga vdekja politike dhe e dyta që duket se vetëm deklarativisht duan të mbesin në opozitë. Të parët duan të bëhen pjesë e qeverisë, të dytët duan të mbesin në opozitë por në dashuri me pozitën e që nuk shkon. PDK-ja ose duhet të sillet si opozitë e vërtetë, ose duhet të fle në një krevat me Hotin. Si përfundim; me këtë pozitë të lodhët dhe me këtë opozitë të përçarë, me një nënshtrim të pakusht ndaj Trampit dhe Grenellit, pa pasur një ofertë serioze, me këtë Ekip Negociator të përbërë nga eunukët politik, rezultati i bisedimeve nuk është aspak premtues. Andaj, në mungesë të një konsensusi politikë për çështje në interes të vendit thuaja e vetmja zgjidhje janë zgjedhjet. Në mos për asgjë tjetër, atëherë, së paku pengohet një zgjidhje e keqe për Kosovën.



Nënshkruhet marrëveshja që çon përpara realizimin e projekteve të efijencës së energjisë

Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, u shpreh se Fondi i Kosovës për Efijencë të Energjisë ka në dispozicion rreth 17 milionë euro dhe nga ky çast është funksional për t'i zbatuar politikat e veta dhe për ta bërë realizimin e projekteve sipas planifikimeve që kanë bërë



Kuçi. Ndërsa kryeshefi i Agjencisë për Efijencë të Energjisë, Arsim Kuliqi, ka theksuar se Kosova është në rrugë të mirë për zbatimin e masave të efijencës së energjisë, që e dëshmon edhe nënshkrimi i kësaj marrëveshje. "Në mbështetje të FKKE-së Qeveria e Republikës së Kosovës është zotuar që për tri vjet radhazi ta mbështesë FKKE-në

me nga 1 milion euro, ku në këtë vit, edhe pse kemi pasur shkurtim të buxhetit, për 25 për qind subvencionimi për FKKE-në ka qenë i paprekshëm nga qeveria", është shprehur Kuliqi. Ndërkaq drejtori i Fondit të Kosovës për Efijencë të Energjisë, Lum Mita, ka potencuar rëndësinë që ka fondi për transformimin e ndërtesave publike si në nivelin

qendror, po ashtu edhe në atë lokal, si dhe në ndërtesa të sektorit privat dhe ka falënderuar ministrin Kuçi për mbështetjen e ofruar për t'i shtyrë përpara projektet që do të na ofrojnë Evropën. Qeveria e Republikës së Kosovës është garantuese e grantit prej 9.6 milionë eurosh dhe kreditë të Bankës Botërore prej 5 milionësh.

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 GUSHT - Me qëllim të përmirësimit të sektorit të energjisë në Kosovë, të mërkurën në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit është nënshkruar marrëveshja në mes të Agjencisë së Kosovës për Efijencë të Energjisë dhe Fondit të Kosovës për Efijencë të Energjisë përmes së cilës do të bëhet kalimi i mjeteve nga AKEE te FKKE, mjete këto që do të jenë në zbatim të projekteve të efijencës së energjisë.

Kosova është shteti i parë në rajon që ka themeluar Fondin për Efijencë të Energjisë si një mekanizëm financiar që do ta mbështesë rritjen e efijencës në sektorin e shërbimeve publike,

sektorin rezidencial apo amvisëritë, sektorin privat etj. Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, u shpreh se Fondi i Kosovës për Efijencë të Energjisë ka në dispozicion rreth 17 milionë euro dhe nga ky çast është funksional për t'i zbatuar politikat e veta dhe për ta bërë realizimin e projekteve sipas planifikimeve që kanë bërë. "Është me rëndësi që këto mjete sa më shpejt të hyjnë në veprim dhe zbatim, me synim të rritjes së zhvillimit ekonomik, ku përfitues të këtij fondi nuk janë vetëm ata faktikë, por edhe ndërmarrjet private. Ndarja e mjeteve sot është rëndësishme ngaqë do ta mundësojë realizimin sa më të shpejtë të projekteve të cilat janë duke u zhvilluar", ka thënë ministri

Mbahet punëtorja "Rimëkëmbja e Telekomit"

PRISHTINË, 26 GUSHT (ER) - Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, ka marrë pjesë në punëtorinë për rimëkëmbjen e Telekomit të Kosovës. Pas situatës së krijuar me bllokimin e llogarive të Telekomit dhe zhbllokimit të tyre më pas, kërkesa kryesore e ministrit Kuçi ka qenë që të prodhohen disa dokumente që do ta tregojnë gjendjen dhe të ardhmen e Telekomit.

Si rrjedhojë, sot, më 26 korrik 2020, u mbajt punëtorja "Rimëkëmbja e Telekomit", e organizuar nga kjo ndërmarrje. Ministri Kuçi gjatë fjalës së tij u bëri me dije pjesëmarrësve se



nga kjo punëtori sa më shpejt duhet të dalin dokumentet që janë kërkuar. "Besoj që të arrihet

qëllimi i kësaj punëtorie, që përpos diskutimeve, të kemi dokumentet që do ta përfshijnë

Planin e Biznesit, Planin e Veprimit për Rimëkëmbje të Telekomit dhe Planin për

Amortizim të borxheve. Kjo është baza mbi të cilën ne do të vazhdojmë më tej për këtë ndërmarrje", ka thënë ministri Kuçi.

Në këtë punëtori folën rreth rëndësisë së këtyre dokumenteve edhe kryesuesi i Bordit të Përkohshëm të Telekomit, Mehmet Berisha dhe u. d. i kryeshefit të Telekomit, Zeqir Kiqina.


Pjesëmarrësit kanë mundur ta dëgjojnë prezantimin për performancën operative dhe të biznesit, performancën financiare, me theks të hyrat dhe gjendjen e sistemeve dhe platformave telekomunikuese.

Bajrami zhvilloi takim virtual me koordinatoren e OKB-së për Zhvillim

PRISHTINË, 26 GUSHT (ER) - Ministri e Financave, Hykmete Bajrami, ka mbajtur një takim virtual me koordinatoren për zhvillim të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Ulrika Richardson, me bashkëpunëtorë, ku ka diskutuar për hapat e për-bashkët rreth implementimit të Planit të Reagimit Socio-Ekonomik ndaj Covid-19 të përgatitur nga Ekipi i Kombeve të Bashkuara në

Kosovë, si dhe për çështje të tjera me interes të për-bashkët. Me këtë rast, Bajrami vlerësoi angazhimin e Kombeve të Bashkuara për ta ndihmuar Kosovën për tejkalimin e sfidave socio-ekonomike që ka shkaktuar pandemia Covid-19. Ajo i njoftoi bashkëbiseduesit me Programin për Rimëkëmbje Ekonomike të aprovuar nga Qeveria e Kosovës dhe theksoi se Plani i Reagimit Socio-Ekonomik

ndaj Covid-19, i përgatitur nga ekipi i OKB-së në Kosovë, është komplementar me përpjekjet e Qeverisë së Kosovës për rigjallërimin e ekonomisë dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve të Kosovës. Palët u pajtuan që t'i koordinojnë aktivitetet e për-bashkëta me qëllim të arritjes së rezultateve sa më të mira për përmirësimin e situatës socio-ekonomike në Kosovë të shkaktuar nga pandemia Covid-19.



Ahmeti: Ky vit shkollor do të fillojë në rrethana krejt ndryshe

PRISHTINË, 26 GUSHT (ER) - Kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, bashkë me drejtoreshën për Arsimit, Shpresa Shala, kanë vizituar të mërkurën shkollën "Faik Konica", ku po bëhen përgatitjet e fundit për fillimin e ri të vitit shkollor. Ahmeti ka thënë se ky vit shkollor do të fillojë në kushte dhe rrethana krejt ndryshe.

"Në takim me drejtoreshën e shkollës Jehona Oruqi, mësimdhënësit e shkollës dhe kryetarin e Këshillit Drejtues, Kushtrim Demiri, diskutuam për masat mbrojtëse kundër Covid-19 dhe respektimin e rregullave dhe protokolleve të hartuara të cilat duhet të zbatohen nga të gjitha shkollat. Ky vit shkollor do të fillojë në kushte dhe rrethana

krejt ndryshe, prandaj edhe është shumë e rëndësishme që të vazhdojmë me kujdes të shtuar dhe respektim të plotë të të gjitha udhëzimeve, që ta ruajmë veten dhe të tjerët rreth nesh. Për ne, në vend të parë janë dhe mbeten shëndeti dhe siguria e fëmijëve tanë!", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".



Komuna e Malishevës ndihmon 450 familje me pako ushqimore

Malishevë, 26 gusht (ER) - Në kuadër të përkrahjes për familjet në nevojë, si pasojë e situatës me pandeminë Covid-19, Komuna e Malishevës ka filluar shpërndarjen e pakove ushqimore dhe higjienike për 450 familje të cilat në një formë apo tjetër janë prekur nga kjo situatë. Shpërndarja e pakove ushqimore po bëhet nga Shtabi Komunal për Menaxhimin e situatës me Covid-19 në territorin e Komunës së Malishevës, ndërsa këto pako ushqimore po shpërndahen përmes kryesive të fshatrave të familjet në nevojë. Shpërndarjen e këtyre pakove e ka parë nga afër edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, i cili ka thënë se "si shtab dhe si

komunë, në vazhdimësi, nga muaji mars, jemi duke u përkrahur për të gjitha rastet që kanë nevojë për përkrahje, pasi gjendja sociale është përkeqësuar si pasojë e pandemisë". "Në vazhdimësi, gjatë këtyre muajve, në bashkëpunim të ngushtë me kryesitë dhe kryetarët e fshatrave, jemi duke u qëndruar afër të gjithë atyre që kanë nevojë për përkrahje përmes mjeteve të komunës apo përmes donatorëve të ndryshëm. Këto pako janë pjesë e mjeteve të ndara nga Asambleja Komunale për menaxhim të situatës me pandemi dhe për mbështetje të familjeve në nevojë gjatë kësaj situatë", ka sqaruar nënkryetari Berisha në emër të shtabit komunal emergjent.



Zemaj: Fushë-Kosovës do t'i ofrohet ndihmë për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore

PRISHTINË, 26 GUSHT (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka vizituar të mërkurën Komunën e Fushë-Kosovës, ku është pritur nga kryetari i kësaj komune Burim Berisha. Zemaj dhe Berisha kanë diskutuar për gjendjen me

Covid-19 në Fushë-Kosovë, derisa i pari i shëndetësisë ka thënë se këtë komunë do ta ketë prioritet. Zemaj ka vizituar edhe Qendrën e Mjekësisë Familjare në Fushë-Kosovë për të parë nga afër se si po ia dalin mjekët dhe stafi tjetër

mjekësor të përballen me pandeminë. "Konfirmova se Fushë-Kosova do të jetë në prioritetin e angazhimit tim dhe do t'i mbështes projektet e caktuara dhe do të ofrohet ndihma për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore", ka thënë Zemaj.

Infektohen me koronavirus 19 punëtore të çerdheve në Pejë

PEJË, 26 GUSHT - Drejtori i Arsimit në Komunën e Pejës, Besim Avdimetaj, ka thënë se në kuadër të përgatitjeve për vitin e ri shkollor, janë testuar punëtorët në një çerdhe. "Për fat të keq, 19 punëtore të çerdheve kanë dalë të infektuara, ndërsa 25 tjera janë në pritje të rezultateve", ka deklaruar Avdimetaj për "Rtv Dukagjinin". Ai ka treguar se të infektuarat nuk janë vetëm edukatore, por përfshijnë edhe kuzhinieret dhe stafin tjetër mbështetës. Drejtori i Arsimit në Komunën e Pejës ka njoftuar se çerdhet

kanë qenë të mbyllura prej një muaji e gjysmë kur edhe është ndërprerë mësimi në gjithë Kosovën. Po ashtu, ai ka bërë me dije se, në bazë të informacioneve që kanë, të gjitha të infektuarat janë pa simptoma. Ai ka thënë se Peja ka bërë përgatitjet për fillimin e vitit shkollor në bazë të udhëzimeve të institucioneve qendrore. Drejtori i Arsimit në Komunën e Pejës thotë se edhe në këtë komunë janë bërë përgatitjet edhe për mbajtjen e testit të maturës.



UÇK-ja KISHTE UNITET TË ÇELIKTË (37)



Shkruan: Kudusi LAMA

Pika 52 e raportit në fjalë është një tentativë për të futur përçarje midis shqiptarëve. Aty thuhet: “Ka dalë qartë se këto ‘grupëzime’ të ndryshme të UÇK-së kanë zhvilluar e ruajtur strukturat e tyre informative, që i kishin ndër të tjera, si një mjet për të siguruar vazhdimësinë e tyre. Përkrahësit më të zellshëm të ndjekjes faktike të kësaj forme lufte të UÇK-së përdorën të gjitha mjetet që kishin, duke e vënë veten, në mënyrë të pamohueshme, në kufirin e ligjshmërisë, për të mbikëqyrur dhe shpesh për të sabotuar veprimin e kundërshtarëve, si dhe të atyre që mund të dëmtonin interesat e tyre politike a ekonomike”. Ndërsa unë po të them se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka pasur që në luftë Shërbimin e vet Informativ, shumë të organizuar dhe që ka kryer me ndershmëri detyrat në interes të atdheut. Dhe ky shërbim ka vijuar të ekzistojë deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës, ka qenë publik dhe nuk ka vepruar i fshehur.

Ky shërbim në punën e tij ka një veprimtari të spikatur dhe me bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë. Ai nuk është marrë me partitë politike që normalisht u krijuan pas përfundimit të luftës, por kreu detyrën deri ditën kur ia dorëzoi shtetit të pavarur të Kosovës. Përveç Shërbimit Informativ të UÇK-së të krijuar që gjatë luftës, në Kosovë nuk ka vepruar asnjë shërbim tjetër legal përveç, ndoshta, ilegalisht edhe UDB-a juaj, e cila ju ka furnizuar me informacionet që jua kanë interesuar. Çdo deklarim ndryshe është në kuadër të shpërdorimit të detyrës që bëni ju, në emër të Këshillit të Evropës.

Deklarimi juaj, se ky shërbim është përdorur për ta “mbikëqyrur dhe shpesh për ta sabotuar veprimin e kundërshtarëve, si dhe të atyre që mund t’i dëmtonin interesat e tyre politike a ekonomike”, është shpifje dhe nuk bazohet në asnjë fakt, përveç në ndonjë artikull gazete të shkruar nga ndonjë gazetar i tipit tuaj, që në emër të lirisë së shtypit mund të shkruajnë çfarë t’u teket, ashtu edhe të kolegut tuaj Bllaca që me të vërtetë jep deklarime të vlefshme, bile “shumë të vlefshme”, i cili është përputhur plotësisht me mendimet dhe veprimet e zbulimet tuaja.

Ajo që është shumë interesante duket se ju paskeni zbuluar që ne kemi edhe një kanun, të cilin e paska zbatuar UÇK-ja, siç e pohoni në pikën 53 të raportit tuaj.

Po si nuk ju ra në sy se UÇK-ja ka pasur një betim ushtarak publik? Si nuk arritët t’i gjeni rregulloret ushtarake të jetës e të disiplinës që ka zbatuar UÇK-ja që nga themelimi i saj? Si nuk ju kanë rënë në sy ato qindra urdhra e komunikata që ka lëshuar Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së gjatë gjithë luftës? Si nuk ju ranë në sy ato struktura organike mbi të cilat është ndërtuar e ka funksionuar UÇK-ja? Si nuk arritët t’i shikoni planet e operacioneve luftarake të formacioneve të UÇK-së për realizimin e misionit të saj? Por duke i tejkaluar të gjitha këto, ju shkuat dhe gjetët kanunin tonë, i cili qenka zbatuar gjatë luftës? Pse jeni kaq i paskrupull?

Kanuni ynë zotëri është një ligj i lashtë që ka ekzistuar kur ti nuk e kishe akoma kombin tënd. Ai ka luajtur një rol shumë të madh në organizimin shoqëror të kohës kur është shpallur. Është një nga ligjet më të lashta të Evropës, në mos më i lashti. Të diturit mburren me përmasat dhe funksionalitetin e tij. Dhe për të të sqaruar zotëri, ai nuk është zbatuar se nuk ka terrenin për t’u zbatuar në kohët e sotme. Por po të zbatohet, duhet ta dini se askush nuk vritet, pasi ai nuk lejon të vriten njerëz fshehtas. Kur vritet me kanun, vrasësi deklaron vrasjen para se ta hetojnë. Në ato kushte nuk do të kishte nevojë për raportin tuaj, pasi çdo gjë do të ishte e deklaruar publikisht. Prandaj mos na merrni nëpër gojë kanunin tonë të lashtë, apo edhe ai ju ka prishur punë.

Në pikën 54 ju deklaroni se “... kemi konstatuar se njësitë kryesore të UÇK-së dhe zonat e tyre përkatëse të komandimit operativ ishin pothuaj kopje e saktë e strukturave që kontrollonin format e ndryshme të kriminalitetit të organizuar në territoret ku vepronte UÇK-ja”. Kush i kishte organizuar këto forma të ndryshme të “kriminalitetit të organizuar” para krijimit të UÇK-së, që ajo i paska gjetur kopje të gatshme? A e kuptoni që flisni me gjuhën e Serbisë? Si paska qenë i organizuar ky kriminalitet në Kosovë kur aty sundonte me zjarr e hekur pushtuesi serb? Si i paskan gjetur këto mënyra organizimi kriminale djemtë dhe vashat luftëtarë me nga një kallash e nga një grusht fishekë nëpër male? Apo mjafton të thuhet fjalë të tilla dhe efektiviteti është i arritur. Për këtë keni të drejtë vërtet me lojëra të tilla fjalësh e akuza pa asnjë të vërtetë. Ju ia arritët ta bindni Këshillin e Evropës. Në këtë kuptim ia keni arritur qëllimit. Veçse duhet të dini që realisht nuk jeni treguar tjetër veçse një kriminel.

Pse nuk thoni çfarë trafikohej nëpër Kosovë e prej Kosove, në kushtet kur atje çdo lëvizje e kontrollonte Serbia? Por, thjesht, në pikën 55 shpreheni se nuk ishte e vështirë “për të kuptuar kush drejtonte trafikimet e ndryshme

apo veprimtaritë e kontrabandës, që lulëzonin në rajon”. Me një fjalë, që ju të mos i quani shqiptarët trafikantë, kontrabandistë e kriminelë, çfarë duhet të kishin bërë ata? Sepse ju e keni gjetur lehtë duke vazhduar shprehjen tuaj: “Mjafton të përcaktohet cili taraf apo cili klan komandantësh a rekrutësh të UÇK-së ishte përgjegjës i një zone operative të përcaktuar të UÇK-së në Kosovë apo në disa rajone të Shqipërisë”. Pra, prej këtej del se të gjithë komandantët dhe luftëtarët e UÇK-së në këndvështrimin tuaj nuk janë tjetër veçse kontrabandistë, trafikantë dhe kriminelë. Me thënë të drejtën, keni hyrë shumë në borxh me shqiptarët zotëri. Ju keni ngarkuar jo vetëm akuza, por keni tentuar t’ju ndyjnë edhe historinë. Dhe këtë, thjesht, për t’i kënaqur interesat e fashizmit ekstrem serb. A vërtet jeni me mendësi fashiste zoti Marty?

Për t’ju sqaruar pak për pikën 56, po ju them se vendimi për themelimin e UÇK-së i përket vitit 1994 dhe ideja është shumë më e hershme. Askush në atë ushtri nuk e ka marrë dot drejtimin sipas dëshirës a sipas forcës, por sipas detyrës së vënë nga strukturat e lëvizjes politike të kohës. Kështu që bërthama më e ngushtë e UÇK-së ka qenë Shtabi i Përgjithshëm, i cili ka pasur fuqinë ta udhëheqë luftën e kësaj ushtrie deri në çlirim. Nëse këto veprime ju i quani veprime kriminale të paligjshme, nuk është faji i UÇK-së e as i drejtuesve të saj. Ndërsa si veprimtari kriminale të tyre në Shqipëri ndoshta quani faktin se duke përfutur nga fakti i ngjarjeve të vitit 1997 që hapën depot e ushtrisë në Shqipëri, bënë një punë shumë të organizuar në grumbullimin e atyre armëve për t’i armatosur luftëtarët në Kosovë. Nëse këtë e quani krim, unë e quaj sa veprimtari humane, po aq edhe atdhetare.

Më pas, në pikën 57 keni shpikur një grup të Drenicës, që realisht në asnjë dokument tjetër, përveç në raportin tuaj, nuk është i emërtuar kështu. Për këtë s’ka pasur as pagëzim e as vetëpagëzim. Atë thjesht e keni pagëzuar ju me serbët, ose serbët në vitin 2004 e ju në vitin 2010. Por ju jeni i mllëfosur për ta emërtuar kështu sepse Drenica ju shkakton alergji psikike pasi, siç deklaroni vetë, Drenica ka qenë “bërthama tradicionale e qëndresës së anëtarëve të etnisë shqiptare ndaj shtypjes serbe në kohën e Millosheviqit dhe vendlindja e UÇK-së”. Për këtë vizitohuni te mjeku se nuk janë fajtorë shqiptarët, por të dashurit tuaj - serbët, të cilët mjaft janë përpjekur ta shuajnë atë trevë, por nuk kanë mundur ta bëjnë pasi qëndresa shqiptare i ka mundur masakrat serbe. Ndërsa Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte e shtrirë në gjithë Kosovën. Megjithëse veprimet e saj ju i quani veprime kriminale, siç i quajnë serbët, ka vepruar me shumë dinjitet duke

arritur t’i hedhë përfundimisht për gjithë të ardhmen shqiptare jashtë serbët dhe ta zhdukun përfundimisht pushtimin prej tyre.

Dhe duke emërtuar të quajturin “Grupi i Drenicës”, ju ia arrini qëllimit të arrini tek emri i udhëheqësit të Kosovës, Hashim Thaçi, të cilin, duke përdorur terminologjitë mafioze, pjesë e të cilëve ndoshta jeni, e emërtoni “kumbara” i rrjeteve të kriminalitetit të organizuar që, sipas jush, nuk janë tjetër vetëm strukturat luftarake të UÇK-së.

Por prapë ju gaboni, pasi Hashim Thaçi gjatë luftës e deri në Konferencën e Rambujesë, ku u zgjodhë unanimisht kryetar i delegacionit shqiptar, nuk ishte tjetër vetëm drejtor i drejtorisë politike në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së. Deri në atë kohë ai nuk ishte i njohur si politikan në skenën ndërkombëtare. Por ju nuk shqetësoheni për këtë. Për ju dhe planet serbe duhet goditur kryetari i Kosovës. A do të arrini vërtet që me mashtrime të ngjiteni deri në ato nivele të qeverisjes së Kosovës? A mos keni bërë edhe ndonjë plan për të na sjellë kryetar ndonjë serb? I shkreti ti sa dëshirë të madhe ke.

Sot Thaçi është politikan i nivelit të lartë, por në kohën kur ju e akuzoni me termat që dini t’i përdorni vetëm ju, ai nuk ishte gjë tjetër veçse një djalosh me armë në krah, që kishte marrë përsipër të luftonte deri në fund të jetës për çlirimin e popullit dhe atdheut të tij prej pushtuesve shekullorë serbë. Në atë kohë të luftës së lavdishme ai nuk kishte kohë të bënte poza si ju sot, për të treguar se ishte i zgjuar dhe është vlerë që ai nuk ka zgjuarsinë tuaj.

Mirëpo ju i ngatëroni kohët, njëherë shkoni në vitet 1998 - 1999, njëherë flisni në kohën e sotme. A e dini se përfaqësuesit e ShBA-së kanë filluar bashkëpunimin me Thaçin prej Konferencës së Rambujesë? A e dini se edhe në atë konferencë të nderuar Thaçi nuk guxoi ta firmoste marrëveshjen pa një konsultë të ngushtë me gjithë luftëtarët dhe komandantët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pasi donte të kishte unanimitet të plotë në pranimin e saj? Apo edhe këto veprime janë kriminale?! Dhe të jeni i sigurt, se pavarësisht organizmit në disa parti politike, në skenën politike sot në Kosovë, në atë kohë nuk kishte asnjë fraksion apo përçarje në radhët e UÇK-së dhe për lumturinë tonë ishte vlerë që nuk kishte, pasi një synim të tillë për të krijuar disa ushtri në Kosovë e kanë shprehur serbët që në atë kohë dhe mos mendoni se nuk kanë tentuar ta bëjnë, por nuk kanë arritur, pikërisht se UÇK-ja kishte unitet të çeliktë.

Në pikën 60 ju thoni: “Thaçi ia detyron pa asnjë dyshim ngjitjen e tij personale përkrahjes politike e diplomatike të Shteteve të Bashkuara dhe të fuqive të tjera

perëndimore, të cilat e konsideronin si partnerin lokal më të parapëlqyer në projektin e tyre të politikës së jashtme për Kosovën. Kjo formë përkrahjeje politike do t’i ketë krijuar konkretisht ndjenjën se është “I paprekshëm” dhe e veshi kështu me një rëndësi tej mase prej drejtuesi të ardhshëm, të besueshëm, të Kosovës së pasluftës”. Unë do të kisha nderim për ShBA-në dhe fuqitë perëndimore nëse do të kenë vlerësuar se Thaçi është një personalitet i vlefshëm për politikën e Kosovës, pasi ata dinë ta bëjnë vlerësimin e nivelit të politikanëve. Nëse është kështu, unë ju falënderoj që na e thoni, por kemi dëgjuar mjaft përralla të tilla, që çdo gjë lind në Perëndim. Realisht UÇK-ja ka lindur në gjirin e popullit të tij dhe i ka nxjerrë prej gjirit të vet kuadrot drejtuese, që sot janë edhe udhëheqës me vlera në politikë.

Prapë në pikën 61 ju shpreheni: “...Thaçi e përforcoi në përmasa fenomenale mbështetjen e tij mbi veprimtaritë kriminale të organizuara gjatë kohës kur këto lulëzuan në Kosovë e në Shqipëri”. Po cilat janë more zotëri këto krime që nuk i emërtoni? A mos e quani krim faktin që bashkëpunëtore e bashkëluftëtare e UÇK-së dhe e Hashim Thaçit (meqë doni t’i përmendni emrin), u bë gjithë bota moderne dhe forca e saj e madhe politike-ushtarake NATO-ja, që goditën bashkë me të pushtuesin e Kosovës deri në çlirim? Në atë kohë i vetmi “krim” që mund të jetë bërë ka qenë armatosja e UÇK-së dhe që edhe ajo për pamundësi nuk është bërë në nivelin e nevojave të saj. Të gjitha krimet e tjera që nënkuptoni kanë ndodhur zotëri vetëm në kokën tuaj, që me sa lexoj në këtë raport ka imagjinatë të sëmurë.

Në pikën 62 thoni: “Thaçi do ketë vepruar në këtë fushë me mbështetjen dhe bashkëfajësinë jo vetëm të strukturave qeverisëse zyrtare të Shqipërisë, dhe konkretisht të qeverisë socialiste në pushtet në atë kohë, por edhe të shërbimeve sekrete shqiptare dhe të mafies së tmerrshme shqiptare”. Po mirë mor zotëri, mbasi Shqipëria paska qenë me shtet mafioz, me shërbim informativ mafioz, me shoqëri mafioze, me mafi të tmerrshme shqiptare, çdo të bënte Thaçi? Natyrisht do të bëhej si ata. Nuk besoj se keni ndonjë mendim tjetër. Këtu bëni shumë mirë, përdërisa në Shqipëri jua kanë pranuar këtë vlerësim për ta. Po si ta ka pranuar Këshilli i Evropës këtë vërtet, nuk e kuptoj. Ju zotëri duhet të paditeni, por unë nuk kuptoj pse lejohesh të jesh i lirë edhe nga Këshilli i Evropës, pasi mendoj se jeni shoqërisht i dëmshëm. Ju sot po godisni Shqipërinë e Kosovën dhe personalitetet e udhëheqjes dhe të politikës së këtyre dy shteteve, po nesër? Ju mund të bëni çdo lloj krimi. (Vijon)



Flet akademik Muhamedin Kullashi (2)

Filozofia është konsideruar dije mbikohore



Intervistoi:
Prof. dr. Haqif MULLIQI

Muhamedin Kullashi është intelektual *par excellence*. Është kënaqësi e madhe që të bisedosh me të dhe të përballësh me elokuencën dhe poliedrizmin e tij. Është akademik. Disa vjet ka qenë profesor në Universitetin "Paris 8" në Francë. Është filozof i shquar, vlerësimet për të cilin janë bërë edhe jashtë hapësirave tona. Profesor Kullashi është autor i një numri të madh të veprave nga fusha e filozofisë e që, sipas mendimit tonë, janë libra që ngërthejnë në vete: filozofinë, sociologjinë, ontologjinë, antropologjinë, teorinë e artit dhe poetikën e tij. Krahas angazhimeve si profesor i njërit prej universiteteve më të njohur në botë, atij "Paris 8", profesor Kullashi kontribut të jashtëzakonshëm ka dhënë edhe për zhvillimin e filozofisë në Universitetin e Prishtinës. Ajo që na ka mahnitur gjithmonë është se Muhamedin Kullashi është edhe njohës i pashoq i fushës së dramaturgjisë dhe teatrit. Titujt e librave të tij janë

të shumtë dhe, prej rreth katër dekadash, si rrallëkujt, veprat e tij janë botuar edhe në gjuhën frënge. Profesor Kullashi disa vite ka shërbyer edhe ambasador i parë fuqiplotë i Republikës së Kosovës në Francë. Këtë intervistë me të e kemi realizuar për revistën për letërsi, kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia".

Roli i filozofisë konsiston në problematizimin e çështjeve, pyetjeve dhe përgjigjeve, të sajara tanimë mbi shoqërinë në përgjithësi

Profesor, cili është roli i filozofisë në shoqërinë bashkëkohore dhe si mund ta kuptojmë rolin e saj në kohën e sotme?

KULLASHI: Të menduarit filozofik tani e më se 25 shekuj ka pasur rol të rëndësishëm në shoqëri, në periudha të ndryshme historike. Roli i saj lidhet me atë që e shquan filozofinë si mënyrë e veçantë e të menduarit, si formë e dijes e ndryshme nga dijet e tjera. Mënyrë e veçantë e definimit të pyetjeve për njeriun dhe raportet e tij me natyrën e botën, e raportit të tij ndaj vetes, ndaj të menduarit dhe pasioneve të tij si dhe me mënyrën e zbrërthimit të tyre. Ky dallim shfaqet edhe atëherë kur ende nuk ishin zhvilluar dallimet midis llojeve të ndryshme të shkencave shoqërore dhe atyre natyrore. Hegeli e shikonte filozofinë si

mendim mbi kohën në të cilën ajo zhvillohet. Ndërkaq, para tij ekzistonte prirja që filozofia të shikohet si dije mbikohore, ndonëse çdonjëra prej filozofive të mëdha trajton problemet me të cilat ballafaqohen njeriu dhe shoqëria në një epokë.

Edhe në shoqërinë bashkëkohore roli i saj konsiston në problematizimin e çështjeve, pyetjeve dhe përgjigjeve të sajara tanimë mbi shoqërinë në përgjithësi, apo për problemet specifike të sferave të ndryshme: politike, ekonomike, kulturore etj. Filozofia luan një rol edhe me kultivimin e një refleksioni dhe raportit të veçantë ndaj historisë dhe ngjarjeve historike. Nuk duhet të harrojmë se këto problematizime të të menduarit filozofik bashkëkohor i formon edhe në saje të lidhjeve të ngushta që i formëson me dije të ndryshme, kryesisht shoqërore dhe humane.

Do ta ilustruj këtë pohim me dy shembuj konkretë. I pari ka të bëjë me filozofinë politike të Claude Lefort mbi njërën nga fenomenet më të rënda të shekullit XX, me fenomenin e totalitarizmit në trajtën e nazizmit, atë të fashizmit dhe të bolshevizmit stalinist.

Ndryshe nga interpretimet që e definojnë totalitarizmin kryesisht si regjim i sundimit të egër, Lefort me koncepte suptile e të thella filozofike shpalos mekanizmat e ndërmarjes totalitare për të

zotëruar, normalizuar dhe uniformizuar "elementin më sekret, më spontan, më të pakapshëm të jetës sociale, brenda zakoneve, shijeve dhe ideve". Derisa momenti i parë, karakteristik për aksionin totalitar, manifestohet në synimin për ta hequr ndarjen midis shtetit dhe shoqërisë, momenti i dytë paraqitet te tendenca për t'i anuluar ndarjet brendapërbrenda shoqërisë.

Te totalitarizmi komunist shoqëria e re afirmohet si shoqëri e cila pretendon se ka tejkaluar antagonizmat e klasave dhe e cila mohon "dallimin e normave sipas të cilave definohet çdo lloj i aktivitetit dhe çdo institucion ku ai ushtrohet". Kësaj, institucione të ndryshme (ndërmarrja ekonomike, shkolla, spitali, administrata, gjyqi) paraqiten aty si "organizata speciale, të subordinuara ndaj qëllimeve të organizatës së madhe socialiste", të nënshtruara ndaj autoritetit politik.

Duke qenë se shoqëria totalitare e shikon veten të pajtuar me veten, projekti totalitar synon ta fshijë *heterogjenitetin social*, "nacionin e llojshmërisë së mënyrave të të jetuarit, të sjelljeve, të besimit, të opinionit". Totalitarizmi e heq dallimin midis shtetit dhe shoqërisë, autonominë relative të kësaj, sikurse edhe pavarësinë relative të sferës së drejtësisë (gjyqeve, prokurorisë etj.)

dhe dijes ngaqë partia e imponon marksizëm-leninizmin si të vetmin botëkuptim të mirëfilltë shkencor. Ndonëse, njëherazi, ai regjim deformat dhe i varfëron teorinë e Marksit, në radhë të parë. Ajo që e cilëson partinë totalitare, ndërkaq, për Lefort, është se së pari fakti se ajo ndërton një *piramidë* të komiteteve, qëllimi i të cilëve është "t'i kontrollojë dhe t'i rregullojë sjelljet në të gjitha fushat e jetës sociale, në të gjitha profesionet por, po ashtu, edhe në të gjitha institucionet ku lidhen marrëdhëniet njerëzore që i shmangen suazës së institucioneve". Për Lefort, objektivi i partisë totalitare nuk gjen shprehje vetëm me vullnetin për sundim, por me një synim më themelor që t'i transformojë efektisht raportet sociale, duke bërë që "gjithçka të jetë e organizuar, gjithçka të jetë materie për organizimin e partisë".

Vendosjen e pushtetit totalitar në Evropë, Lefort e shpjegon si *përmbysje* të rendit demokratik ashtu siç u sajua në modernitet. Originaliteti i konceptit të Lefortit për *demokracinë* shpërfaqet, veç të tjerash, në mënyrën e analizës së fenomeneve të veçanta të demokracisë moderne. Kësaj, kuptimi i transformimit të rendit simbolik, që shënon burimin e demokracisë moderne, shfaqet edhe me vendosjen e një pushteti, veprimet e të cilit janë të kufizuara, parimisht, me ligje. Këto veprime,

po kështu, zhvillohen brenda ndarjes, që cilëson modernitetin, midis shoqërisë civile dhe shtetit. Duke insistuar te *karakteri simbolik i pushtetit*, Lefort njëherësh kritikon autorët që e reduktojnë pushtetin në funksion të një organi, të një instrumenti, i cili do të ishte në shërbim të forcave sociale, të cilat sikur i paraprijnë vendosjes së atij pushteti. Pushteti brenda rendit demokratik del si i papërvetësueshëm nga ndonjë individ ngaqë ardhja në pushtet kalon doemos nëpërmjet një procedure të garave politike, sipas një periudhe kohore (mandati katër ose pesëvjeçar i një qeverie apo presidenti), sipas procedurës së zgjedhjeve dhe votimit. Lefort nënvizon se kjo procedurë e garave politike dhe zgjedhjeve implikon edhe fenomenin e “institucionalizimit të konfliktit”. Kjo do të thotë se aftësia e demokracisë qëndron edhe te fakti se ajo, me funksionimin e institucioneve të veta, bën të mundur *transformimin e pasioneve të dhunshme dhe konflikteve të dhunshme në rivalitete dhe gara politike*, se ajo bën të mundur, me debate e praktika të tjera politike, *sublimimin e dhunës brutale*. Për ndriçimin e totalitarizmit në bashkëkohësi, krahas konceptioneve të Leforit, janë të rëndësishme edhe ato të Hannah Arendt dhe Raymond Aron.

Cili është shembulli i dytë që keni parasysh për rolin e filozofisë në shoqëritë e sotme?

KULLASHI: E kam fjalën për kërkimet filozofike mbi teknikën dhe teknologjitë e reja dhe sfidat që këto i ngrenë për shoqëritë e sotme. Prania e teknikës, me format e saj të shumëllojshme dhe zhvillimi i teknologjive në shoqëritë e sotme janë bërë tema të theksuara të filozofisë bashkëkohore, duke nxitur refleksione e debate brenda rrymave të ndryshme. Filozofi bashkëkohor francez Bernard Stiegler është një nga mendimtarët

më të shquar bashkëkohor që shtjelloi raportet midis teknikës dhe njeriut dhe teknikës e kohës në botën e sotme. Vepra e tij *Teknika dhe koha* konsiderohet si një nga veprat e çmuara të të sotmes për këtë tematikë. Ai vë në pah një shqetësim të thellë, i nxitur nga teknika. Në njërën nga konstatimet e para, Stiegler cek se, ndonëse teknika vazhdon të mendohet si “mjet” në shërbim të një “qëllimi” (njeriu, kultura), që nga revolucioni industrial, ky definicion tani është gjithnjë e më pak i qartë. Ngaqë “qëllimi” të cilit ajo duhet t’i shërbejë është transformuar thellësisht, kurse dija teorike e cila duhet ta shpjegojë njeriun dhe botën nuk është në nivelin e obligimit që ka në përballjen me këto fenomene. Sipas tij, arsyeja qëndron te vazhdimi i ndarjes midis shkencës si diskurs i vërtetë mbi atë që është dhe teknikës si zbatim i zbulimeve shkencore. Ai vë në pah se në emër të modernizimit, rregullat që drejtonin proceset ekonomike dhe sociale-politike janë ndryshuar nën ndikimin e inovacioneve tekno-shkencore. Stiegler konstaton një *përmbysje thjesht të paparë të qëllimit dhe mjeteve*: koha publike dhe private nuk zhvillohet më sipas “kalendarit” njerëzor, por sipas ritmit të “risive” teknike dhe zbatimit të një rregulle të vetme të liberalizmit: duhet të adaptohesh ose të zhdukesh.

Stiegler shton se këtë situatë bashkëkohore e cilëson edhe zëvendësimi i pyetjes filozofike “ç’është njeriu?” me pyetjen “çka mundet tekno-shkenca?”, pyetje kjo e bartur me *vrapin kah inovacionet*. Mirëpo ky filozof i teknikës mendon se refleksioni doemos duhet të ballafaqohet me sfidat që i shtron zhvillimi teknologjik.

Një nga filozofët që vuri në dukje në mënyrë lucide disa aspekte shqetësuese të evoluimit të teknologjive më të reja është Jean-Michel Besnier. Një prej tyre ka të bëjë me zhvillimin e lëvizjeve “trans-humaniste” që flasin me seriozitet për *zëvendësimin e njeriut me makina e robotë të cilët gjithnjë e më shumë do të veprojnë në mënyrë autonome*. Një aspekt tjetër shqetësues, të cilin e vë në pah Besnier, ka të bëjë me lëkundjen e *drejtpeshimit* në favor të teknikës, i cili u ruajt midis teknikës dhe fjalës (ligjëritimit), mjeteve dhe fjalës, në procesin e zotërimit të natyrës dhe emancipimit ndaj saj, në procesin e ndërtimit të *njerëzisë* së njeriut. Tani, në rrethanat të mbizotërimit të teknologjive të reja të komunikimit, *ligjërimi gjithnjë e më shumë reduktohet dhe varfërohet nën presionin e makinave që duan ta thjeshtësojnë atë*, ta transformojnë, madje edhe ta bëjnë të *panevojshëm*, fjala vjen në teknologjitë e Webit, si SMS etj.




Ahmed METAR

SIKUR TË ISHA PRESIDENT

Sikur të isha president arab, do ta zgjidhja problemin dhe do ta rehatoja popullin nga barrët që e kanë rënduar. Unë, sikur të isha president, do t’i ftoja presidentët dhe do t’u mbaja një fjalim të shkurtër për vuajtjet që i përjeton populli ynë, dhe për sekretin e mjerimit, do t’i ndërprisja të gjitha pyetjet, do ta lexoja besmelen dhe do ta hidhja bombën mbi ta e mbi veten time.

Shënim për autorin

Ahmed Metar, poet irakian. Filloi të shkruajë poezi në moshën katërbëdhjetëvjeçare dhe shumë shpejt u bë i njohur me botimin e pamfleteve politike. Është autor i disa përmbledhjeve me poezi dhe i disa pamfleteve, të cilat në gjuhën shqipe është duke i përkthyer profesori Jahja Hondozi, i cili këtë poezi e ka përkthyer posaçërisht për revistën “Akademia”, nr. 6.



Pastaj fantazmat që mbijnë në fushën e neuroshkencave, e të cilat, sipas disa *trans-humanistëve* (si Kevin Warwick), do të duhej të kontribuonin ta bëjnë të *tepërt këmbimin me fjalë* për hir të realizimit të diapozitivave të komunikimit me valët elektromagnetike, duke sendërtuar kështu ekuivalentin e një relacioni telepatik. Autori i kësaj teknike si *dehumanizuese* dhe shprehje e tendencës për ta hequr nga vetja

kompleksitetin e perceptimeve dhe shprehjeve që e bëjnë njeriun të dallohet thellësisht nga makinat.

(Intervistën e plotë mund ta lexoni në numrin e tetë të revistës “Akademia” që sapo ka dalë nga shtypi. Revistën e gjeni në librarinë “Artini”, “Dukagjini” dhe në redaksinë e gazetës “Epoka e re” në Prishtinë. Të drejtën e botimit: “Akademia” dhe shtëpia botuese “Armagedoni”)

LIRIA NUK ËSHTË KRIM!



Ed'hem SHERKAVI

Përktheu nga arabishtja: Jahja Hondozi

Të gjithë njerëzit, arabë e të huaj, lindorë dhe perëndimorë, me të gjitha fetë e racat e tyre të ndryshme dhe nivelet e tyre shoqërore dhe ekonomike, pajtohen njëzëri se çdo grup njerëzor duhet të ketë ligje që e rregullojnë atë. Familja, kompania, punëtorja, shkolla, ministria dhe shteti, madje edhe kafenetë, që të gjitha u nënshtrohen ligjeve të shkruara apo traditave që vlejné si ligj.

Ligjet janë përherë sikurse njerëzit. Ka prej tyre që nxisin të qeshura dhe habi, siç ka edhe të tillë që të detyrojnë t’ua ngrë-hësh kapelën në shenjë respekti. Para disa ditësh kuptova se përpjekja për të ikur nga burgu në Gjermani dhe Austri nuk përbën krim dhe për të nuk para-shihet dënimi. Ikësi, thjesht, kthehet për ta plotësuar dënimin nga i cili kishte ikur. Ndërkaq, sa i përket ndonjë dënimi tjetër të cilin do të vuante, një gjë e tillë varet nga veprat po që se i ka bërë gjatë ikjes, që është rast sikurse edhe rasti i njerëzve të tjerë jashtë burgut. Shkaku qëndron aty se ata e konsiderojnë përpjekjen për liri një instinkt njerëzor. Burgjet nuk janë vetëm ato ndërtesa fort të mbyllura dhe qelitë nuk janë vetëm ato dhoma të ngushta! Ka edhe burgje në formë vendlindjesh! Nuk është e domosdoshme të jesh i lidhur me

zinxhirë për të qenë i burgosur. Ka zgjedhje edhe më të ashpra e më të rënda se kjo të cilat nganjëherë janë në formë ligjesh e traditash. Përpjekja për t’u çliruar nga këto burgje të jetuara e të padukshme nuk është krim, por të kënaqurit me to është krimi më i tmerrshëm që e bëjmë kundrejt të drejtës sonë dhe të drejtës së ardhmërisë të fëmijëve tanë! Shteti në të cilin nuk të lejohet të mendosh ndryshe përveç si mendon qeveria, është burg! Shteti në të cilin ti e shpenzon edhe qindarkën e fundit për shkollimin e fëmijëve të tu, e pastaj rri duke i shikuar ata pa punë sepse nuk ke ndërmjetësues, është burg! Shteti në të cilin mjekohet i pasuri, kurse i varfëri vdes pranë dyerve të spitaleve, është burg! Shteti i cili kërkon prej teje tatime, e kur ti ke nevojë për të, të thotë: “Shko ti dhe Zoti yt luftoni, ne po

rrimë këtu!” (Kuran, kaptina Tryeza, ajeti 24), është burg! Shteti, qeveria e të cilit merr argatë kundër teje, dijetarë “remote control” dhe fetva sipas masës së qeveritarit, është burg! Shteti i cili i ndan patundshmëritë e veta dhe i dhuron tokat e veta para syve të tu, përderisa toka e vetme që të lejohet ta kesh është varri si shpëtim në fund të shërbimit, është burg! Shteti në të cilin dridhesh kur e shikon një polic, në vend se të ndiesh siguri, është burg! Shteti, në gjykatën e të cilit kur hyn, dridhesh sikurse ai që i afrohet gjyqinës, ngaqë e di se “drejtësia është themel i push-tetit”, s’është tjetër pos një slogan mbi kokën e gjykatësit, është burg! Madje, edhe kur zemërohen në ty, nxjerrin vendim për të të ndaluar nga udhëtimi. A nuk po e sheh se ata pohojnë

dhe pranojnë se jeta në një realitet të këtyllë është dënimi dhe se një shtet si ky është thjesht burg?! (El-Vatan, 10.10.2017)

(Marrë nga numri i tetë i revistës “Akademia”. Të drejtën e botimit: “Akademia” dhe shtëpia botuese “Armagedoni”. Revistën e gjeni në librarinë “Artini”, “Dukagjini” dhe në redaksinë e gazetës “Epoka e re” në Prishtinë)

Shënim për autorin

SHERKAVI, Ed'hem
Shkrimtar palestinez. Lindi në Liban, në qytetin Sur. Ka magjistruar për letërsi arabe në Universitetin e Bejrutit. Ka punuar një kohë për gazetën e Katarit El-Vatan. Librin e parë me titull Ehadithus-sabah (Bisedat e mëngjesit) e botoi në vitin 2012. Shkrimet i boton me nofkën Kuss ibn Sa'ide.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Gjilani s'ka frikë nga APOEL-i, kërkon kualifikimin

Gjilani sonte në stadiumin "Fadil Vokrri" e pret APOEL Nicosia, derisa trajneri Gentian Mezani është optimist para kësaj sfide. "Unë mendoj se kjo është një ndeshje tjetër për nga cilësia, jo si ndaj Tre Pennes. Optimizmi është pasi në futboll mund të ndodhë gjithçka. APOEL-i është ekip me buxhet shumë më të madh se ne, por nuk është ai APOEL-i i mëparshëm. Kemi punuar në të gjitha aspektet, sidomos në atë defanziv, pasi kundërshtari ka shumë cilësi në sulm. Mendoj se gjasat janë 50-50", ka thënë Mezani



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 26 GUSHT - Nënkampioni i Kosovës në futboll, Gjilani, të mërkurën në mëngjes në Kukës të Shqipërisë bëri testet për Covid-19. Më pas klubi nga Anamorava "aterroi" në stadiumin "Fadil Vokrri" për ta kryer stërvitjen e fundit para ndeshjes kundër APOEL Nicosia, e vlefshme për raundin e parë parakualifikuese në Ligën e Evropës.

Trajneri i kësaj skuadre, Gentian Mezani, ka thënë se kjo ndeshje është

me ndryshe se ajo e kaluara kundër Tre Pennes, derisa ka shfaqur optimizëm se Gjilani mund ta arrijë kualifikimin. "Unë mendoj se për nga cilësia kjo është një ndeshje tjetër dhe jo si ndaj Tre Pennes. Optimizmi është pasi në futboll mund të ndodhë gjithçka. APOEL-i është ekip me buxhet shumë më të madh se ne, por nuk është ai APOEL-i i mëparshëm. Kemi punuar në të gjitha aspektet, sidomos në atë defanziv, pasi kundërshtari ka shumë cilësi në sulm. Mendoj se gjasat janë 50-50", ka thënë Mezani.

Edhe mesfushori Muhamed Useini ka

shfaqur optimizëm para ndeshjes që zhvillohet sot (e enjte) në Prishtinë. Useini ka thënë se nuk kanë frikë nga kundërshtari qipriot dhe se do të provojnë të luajnë për fitore. "Jemi të përgatitur. Nuk duhet të frikësohemi. Befasitë janë të mirëseardhura në futboll. Ne do të provojmë të fitojmë", ka thënë Useini. Gjilani e mposhti në fazën preliminare të kësaj gare, Tre Pennen, me rezultat 1-3. Ndeshja në mes të Gjilanit dhe APOEL-it, e vlefshme për raundin e parë, zhvillohet sonte (e enjte) nga ora 19:00 në stadiumin "Fadil Vokrri".

SHKURT

Thaqi lë Prishtinën për Ballkanin

FC Ballkani ka zyrtarizuar transferimin e Armend Thaqit. Ish-kapiteni i Prishtinës karrierën do ta vazhdojë në skuadrën e drejtuar nga trajneri Ismet Munishi. "Armend Thaqi është futbollisti më i ri i FC Ballkanit. Kemi kënaqësinë t'ju informojmë se mbrojtësi i djathtë, Armend Thaqi, sot ka vendosur të na bashkohet për 2 sezonet e ardhshme. Thaqi do të prezantohet zyrtarisht në ambientet e klubit në ditët në vazhdim. Na priftë e mbara Armend!", thuhet në njoftimin e Ballkanit.

Miftaraj konfirmon largimin nga Prishtina

Mesfushori Diar Miftaraj edhe zyrtarisht nuk do të jetë më pjesë e skuadrës së Prishtinës. Pas tri edicioneve, Miftaraj largohet nga skuadra "bardhekaltër" për të provuar një tjetër përvojë në karrierën e futbollit. "Ka qenë një vendim shumë i vështirë, pasi që kam kaluar te Prishtina tri vjet shumë të mira. Mirëpo tani kam vendosur të largohem dhe klubit i uroj shumë suksese. Për mua ka qenë nder i madh që të luaj për tri vjet për klubin më të madh në Kosovë", ka thënë Miftaraj për "Olle".

Plaku, afër largimit nga Gjilani

Sebino Plaku do të largohet nga Gjilani. Sulmuesi që ka një përvojë të madhe në Superiore, verën e kaluar nënshkroi për Llapin, por në Podujevë gjërat nuk shkuan si duhet për të. Gjilani e kërkoi në janar dhe në fund palët gjetën gjuhën e përbashkët dhe sulmuesi u vu nën urdhrat e trajnerit Gentian Mezani. Te Gjilani ai u mundua ta ndihmonte skuadrën, që në fund e mbylli në vend të dytë. Mes sulmuesit dhe klubit dardan ka pasur bisedime për rinovimin e marrëveshjes, por oferta e bërë nuk ka qenë e kënaqshme dhe gjasat janë që Plaku të ndryshojë skuadër.

Rrahmani: Luaj kudo që kërkon Gattuso

NAPOLI, 26 GUSHT - Kapiteni i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Amir Rrahmani, nga Hellas Verona e ka kompletuar transferimin te Napoli dhe mezi pret të fillojë këtë aventurë të re. "Unë jam një

mbrojtës agresiv, i fortë në duelet ajrore. Këto janë karakteristikat e mia kryesore", ka deklaruar Rrahmani. "Unë kam luajtur tash në sistemin me katër mbrojtës, madje edhe në ekipin tim

kombëtar. Kështu që nuk është diçka e re për mua. Unë nuk kam shënuar në sezonin e parë në Serinë A. Isha i pafat. Shpresoj të shënoj me Napolin", ka shtuar Rrahmani. Mbrojtësi "dardan" ka thënë

se është i gatshëm të luajë në secilin pozicion që i kërkon trajneri Genaro Gattuso. "Unë mund të luaj në secilën pozitë. Jam gati të luaj në çdo rol që trajneri më kërkon", ka deklaruar ai.



Marquez: Dovizioso mund të shpallet kampion në Moto GP

MADRID, 26 GUSHT - Marc Marquez, kampioni i botës në fuqi në Moto GP, pasi hoqi dorë nga gara për trofe këtë sezon, për shkak të dëmtimit dhe mungesës së gjatë në pistë, ka piketuar pilotin që mund ta fitojë titullin këtë

sezon. Sipas pilotit spanjoll, Andrea Dovizioso me Ducati mund të shpallet kampion këtë sezon në Moto GP. "Pas garës së Jerez do të vija bast për Fabio Quartararo, pasi fitoi dy garat e para, por tani kam dyshime", ka thënë Marquez.

"Në garat e tjera ka qenë në vështirësi. Në garë përqendrimi është i rëndësishëm, sidomos në çaste të vështira. Është i talentuar, është i shpejtë, por nuk e shoh gjithnjë të përkryer në pistë", ka shtuar Marc Marquez. "Ndaj besoj se

Dovizioso ka karakteristikat për të qenë kampion, pasi është konstant dhe ka përvojë. Ai e meriton të shpallet kampion, pasi ka vite që duelon për titullin me mua. Nëse nuk bën gabime, e fiton titullin", ka shtuar Marquez.



Aliaj: Vojvoda do të jetë surpriza e Serisë A

TIRANË, 26 GUSHT - Mërgim Vojvoda kreu hapin e madh në karrierë duke u transferuar nga Belgjika në një nga ligat kryesore siç është Seria A ku do ta veshë fanellën e Torinos. Përfaqësuesi i Vojvodës, menaxheri i njohur shqiptar Adrian Aliaj, për "Supersport" zbulon se pse në fund zgjodhën klubin "granata". "Transferimi i Vojvodës në kampionatin italian është një surprizë për mua, por jam shumë krenar për këtë lëvizje, pasi bëhet fjalë për një lojtar me shumë vlera. Ishte në lojë edhe Atalanta, por zgjodhëm Torinon, pasi këmbënguli shumë më tepër dhe mendoj se bëmë zgjedhjen e duhur. Mërgimi do të jetë titullar absolut në Torino dhe Giampaolo aplikon një skemë që i përshtatet shumë atij", ka thënë Aliaj. "Te Mërgimi kam shumë besim që do të jetë i suksesshëm, sepse është rritur në kampionatin belg te



Standardi. Nuk ka kaluar fare nga Shqipëria apo Kosova dhe është një djalë me mentalitet evropian, profesionist dhe nuk kam dyshim se do të jetë surpriza e kampionatit. Do ta shihni vetë. Transferimi i Rrahmanit te Napoli, ishte kulmi i punës sonë në ato çaste, ndaj jemi shumë të lumtur me këtë marrëveshje", u shpreh Aliaj. A do të jetë kampionati

italian, parajsa e madhe e lojtarëve shqiptarë, Aliaj është i bindur që shumë lojtarë nga trevat shqiptare janë të aftë të luajnë në Serinë A. "Shqiptarët kanë treguar veten në Itali dhe kanë kualitetin e duhur për të luajtur në Serinë A. Shumë shpejt do të vijnë edhe emra të tjerë këtu, pasi edhe ne po punojmë në këtë drejtim", u shpreh Aliaj.

Barcelona: Po bëjmë gjithçka për ta mbajtur Messin

BARCELONË, 26 GUSHT - Skuadra e Barcelonës po punon për ta mbajtur Leo Messin. Lajmin e ka konfirmuar sekretari teknik i klubit blaugrana, Ramon Planes, duke sqaruar situatën e krijuar. "Duam të ndërtojmë një cikël të ri fitues, krahas më të mirëve në botë dhe më të mirëve në histori. Nuk mendojmë për asnjë lëshim (largim) të Messit. Ne e respektojmë Messin. Është më i miri në botë. E ardhmja që kemi përpara është pozitive. Jam optimist për ekipin. Nuk lëvizim nga kjo ide. Messi i ka dhënë aq shumë Barçës dhe e kundërta; Barça i dha kaq shumë Messit. Martesa ishte pozitive. Ne duam që ajo të vazhdojë. Unë e kuptoj që ky është një lajm shumë i rëndësishëm. Është normal, por po punojmë për ta gjetur zgjidhjen më të mirë për klubin dhe për Messin. Po përpiqemi të krijojmë një ekip të shkëlqyer, me respekt



për ata që kanë qenë këtu për një kohë të gjatë, por me idenë për të shtuar lojtarë të rinj", ka thënë Ramon Planes. "Brenda klubit nuk ka përçarje. Unë e kam shijuar Messin që kur kam ardhur këtu. Është kënaqësi e jashtëzakonshme që e kemi në ekip. Ai është lojtar fitues në një klub fitues. E vetmja gjë që duam është të fitojmë përsëri me të. A do të

jetë në grumbullim të hënën? Unë e kuptoj nevojën për informacion, por i gjithë komunikimi mes nesh duhet të mbetet i brendshëm. Këto janë situata për të cilat po flasim, po përpiqemi të ndërtojmë së bashku një të ardhme. Ne do t'i bëjmë përpjekjet tona për ta arritur këtë qëllim", deklaroi sekretari teknik i klubit, Ramon Planes.

SHKURT

Rummenigge: Alaba nuk largohet nga Bayerni

Zyrtari i lartë i Bayern Munchenit, Karl-Heinz Rummenigge, beson se David Alava do të mbetet në klub. Ishte paralajmëruar kohë më parë se reprezentuesi austriak do të largohet nga skuadra fituese e Ligës së Kampionëve, por Rummenigge ka thënë se pret që Alaba të mbetet në "Allianz Arena". "Me dëshirën më të madhe nuk mund ta paramendoj se Davidi dëshiron të largohet nga Bayerni. Ne jemi shumë të interesuar për qëndrimin e tij. Mendoj se ndihet si në shtëpi", ka deklaruar Rummenigge për "Bild".

Ibra vazhdon me Milanin

AC Milan dhe Zlatan Ibrahimoviçi do ta vazhdojnë rrugën bashkë. Pritet vetëm zyrtarizimi me firmat në kontratë, por rinovimi i sulmuesit suedez është fakt i kryer. Mediat italiane bëjnë me dije se palët kanë arritur marrëveshjen, duke rënë dakord sa iu përket termave financiarë që kishin rrezikuar qëndrimin e sulmuesit. Ky i fundit do të fitojë 6 milionë euro në sezon, ndërsa janë modifikuar bonuset që ai mund të arketojë deri në fund të kontratës. Në këtë mënyrë njoftimi zyrtar për rinovimin e Zlatan Ibrahimoviçit pritët të vijë nga çasti në çast.

Puyol, Messit: Ke gjithë mbështetjen time

Lionel Messi ka kërkuar të largohet nga klubi i Barcelonës. Ai ka thënë se i ka dërguar një letër klubit, duke thënë se dëshiron të shfrytëzojë një klauzolë në kontratën e tij, që i lejon të largohet menjëherë, pa ndonjë pagesë. Ka qenë një legjendë e ekipit katalanas si Carles Puyol që me një postim në rrjetet sociale duket se ka konfirmuar largimin e argentinasi nga skuadra. "Respekt dhe admirim për ty Leo. Ke gjithë mbështetjen time shok", ka shkruar Puyol në "Twitter".

Pedro prezantohet te Roma

Pedro Rodriguez u prezantua zyrtarisht si futbollist i Romës teksa pozoj edhe me fanellën zyrtare të skuadrës nga kryeqyteti italian. I ardhur nga Chelsea me parametra zero, pasi i kishte përfunduar kontrata me londinezët, Pedro bëhet afrimi i parë i "erës" Friedkin te Roma, pasi miliarderi amerikan bleu aksionet e klubit pak ditë më parë. Futbollisti spanjoll nënshkroi kontratën që do ta mbajë në Romë për 3 sezone dhe do të përfitojë një pagë prej 3 milionë eurosh në vit.

Vardy, deri në pension te Leicesteri

Jamie Vardy ka nënshkruar kontratën e re dhe praktikisht do ta mbyllë karrierën te Leicester City, aty ku ai ka fituar titullin kampion në Premierë Ligë dhe "Këpucën e Artë". Sezonin e fundit ai shënoi 23 gola dhe u shpall golashënuesi më i mirë. "Dhelprat" i ofruan rinovimin dhe Vardy ka nënshkruar një marrëveshje që e lë te Leicesteri deri më 30 qershor të vitit 2023. Sulmuesi 33-vjeçar tha fjalët e para pas rinovimit të kontratës: "Rrugëtimin që kam përshkruar në këtë klub është i vështirë të përshkruhet me fjalë. Edhe pse kemi arritur shumë së bashku, unë kam marrë më shumë nga ky ekip. Për këtë arsye jam i lumtur që jam në gjendje të rinovoj edhe një herë me Leicester Cityn. Më pëlqen të luaj futboll para tifozëve të këtij klubi dhe jam i kënaqur që vazhdoj udhëtimin këtu".



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:206/1
Dt: 26.08.2020

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 4, Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendra e Kompetencës në Ferizaj dhe Qendrën e Kompetencës në Malisheve për vitin shkollor 2020/2021

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Ferizaj	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën Matematikës me 16 orë mësimore; Një(1) mësimdhënës/e për Optikë me 10 orë mësimore;	Zëvendësim deri në kthimin nga pushimi i lehonisë Zëvendësim deri në kthimin nga pushimi i lehonisë
SHML	Qendra e Kompetencës	Malisheve	Një (1) mësimdhënës /e për lëndën e Instalues ujësjellësi e kanalizimi dhe ngrohje e klimatizimi me 20 orë mësimore;	Vend i lirë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillt me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe procese mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Në mungesë të vlerësimit dhe vlerësimit mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar.

Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 15 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj dhe Qendra e Kompetencës Malisheve. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës. Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale. Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



Në bazë të Ligjit Nr.03/L-145 për Fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë, neni 12 paragrafi 3 dhe 4, të aprovuar më 30 shtator 2009 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ Nr.11/2010 si dhe nenet 4 dhe 5 për licencimin e Qendrave rinore publike, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, shpall:

KONKURS

PËR LICENCIM TË QENDRËS RINORE PUBLIKE 12/38

PRANUAR MË: 26-08-2020
ACCEPTED ON:
PRIMJENO:

Konkursi është i hapur për OJQ-të lokale të cilat në programin e tyre ekskluzivisht kanë rininë. Komuna e Malishevës do të përzgjedhë një OJQ, e cila do të ushtrojë veprimtarinë e saj në fushën e rinisë në hapësirën të cilën komuna e ka ndarë për këtë destinim.

Kushtet për Licencim të Qendrës Rinore Publike:

- Organizata Joqeveritare që ofron shërbime dhe aktivitete ekskluzivisht për rininë;
- Program të qartë për fuqizim dhe pjesëmarrje të të rinjve;
- Strukturë vullnetare.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

- Certifikata e vlefshme e regjistrimit të OJQ-së;
- Statuti i Organizatës;
- Plani i punës për një vjet;
- Raporti i aktiviteteve të mëparshme dhe hapësira e veprimtarisë;
- Biografite e personelit menaxhues;
- Dëshmi për strukturën organizative të brendshme dhe funksionimin e Kuvendit Anëtarëve.
- Referencë për kryerjen apo zhvillimin e aktiviteteve me karakter rinor (lëshuar nga organet gjegjëse)

Vërejtje: Kërkesat të cilat paraqiten pas afatit të caktuar nuk do të pranohen.

Të gjitha kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.
Formularin e aplikimit mund ta merrni në zyrën pritëse të komunës.
Të gjitha dokumentet e kërkuara me konkurs dorëzohen në zyrën pritëse të komunës.
Kontrata për udhëheqjen e Qendrës Rinore do të jetë 3 vjeçare.
Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në gazetën Epoka e Re dhe në uebfaqen e komunës.



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Vëllezërit Morina" Sh.p.k Reçan, Suhareke, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për prodhimin e kupëzave të betonit në Bostanishte zone kadastrale Reçan komuna e Suharekës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 21.09.2020 në ora 10:00 në hapësirat e fabrikës "Vëllezërit Morina" në fshatin Reçan, komuna Suharekë do të organizohet debat publik nga kompania "Vëllezërit Morina" Sh.p.k Reçan, Suhareke, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për prodhimin e kupëzave të betonit në Bostanishte zone kadastrale Reçan komuna e Suharekës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=UmQvcFNU NGQrZVFOM3RnU0d2K283Zz09>

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



N.P.L. STACIONI I AUTOBUSËVE RAHOVEC SH.A

Nr. 01/20
Me datë: 27.08.2020
Rahovec

N.P.L. "Stacioni i Autobusëve Rahovec" SH.A., në bazë të nenin 25 paragrafi 2 pika (h) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Nr. 03/L-087, ndryshim plotësimin e Ligjit për NP-të Nr.04/L-111 neni 13, vendimit nr. 01/2020 të datës 24.08.2020 të Bordit të Drejtorëve, shpall :

KONKURS

Pozita e punës: Sekretar (1 pozitë).
Kohëzgjatja e kontratës: 3 vite, me mundësi vazhdimi.
Orari i punës: I plotë.
Vendi: Rahovec

Detyrat dhe përgjegjësitë :

- Organizon, kordinon dhe udhëheqë me punët e Dep. Administrativ.
- Merr pjesë në bledhjet e stafit udhëheqës dhe mbledhjet tjera sipas nevojës.
- Jep keshilla juridike punëtorve të NP:
- Merr pjesë në krijimin e politikës afariste nga Dep.
- Koordinon punët me shërbimet tjera në kuader të NP.
- Menaxhon përfaqsimin e NP në të gjitha Gjykatat e rregullta në të gjitha kontestet dhe kundërshtimet sipas urdhërpagesave.
- Bënë interpretimin dhe sqarimin edispozitive e akteve normative dhe ligjeve të tjera fuqi lidhur me realizimin e administrimit.
- I zbaton punët paraprake për pranimin e punëtorve në marrëdhënie pune siç janë: paraqitja e nevojës për punëtor, shpalljet, konkuret dhe veprimet tjera të nevojshme që rezultojn nga ligjet aplikuese në Kosovë:
- Vepron si agjent i NP për pranimin e njoftimeve:
- Kryen të gjitha arkivimet, publikimet dhe/ose zbulimet për autoritetet perkatëse siç mund të kërkohen me ligj:
- Mbikëqyrë mirëmbajtjen e duhur dhe azhurnimin e rregullt të uebfaqës:
- Kordinon me KSHE përgatitjen e letrave (dokumente) për mbledhjet e bordit të Drejtorëve:
- Mbanë procesverbalin e secilës mbledhje të përgjithshme dhe Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit:

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim

Kandidati përveç kushteve të lartë shënuar duhet të plotëson edhe kushtet e përgjithshme të parapara sipas ligjit mbi shërbimin civil nr.03/L-149, si dhe ligjet e aplikueshme të Kosovës, të mos jenë nën hetime penale apo i dënuar për veprë penale.

Procedurat e konkurrimit

Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.

Shkollimi i kërkuar

Përgatitja shkollore : Diplomë universitare -drejtimi juridik.

Njohuri të thellë dhe të specializuar në fushën e legjislacionit dhe hartimin e akteve ligjore
Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme
Shkathësi në komunikim planifikim të punës koordinimi eventual i personelit në nivel administrativ
Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale
Shkathësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access)

Dokumentet që kërkohen:

- Diploma
- Vërtetimi që nuk është nën hetime
- CV-ja
- Kopja e letërnjoftimit
- Dëshmi e përvojës së punës

Kandidatët e suksesshëm do t'i nënshtrohen testimit dhe intervistës.

Data e hapjes dhe e mbylljes së konkursit:

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.

Afati për dorëzimin e aplikacioneve është nga data 27.08.2020 dhe përfundon më datë 11.09.2020 në ora 16:00.

Paraqitja e kërkesave

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e drejtorit në Stacionin e Autobusëve në Rahovec
Adresa: Rruga Xhelal Hajda- Toni pn. Rahovec

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen

Shënoni emri dhe mbiemri, numri i telefonit të personit i cili mund të kontaktohet në rast të ndonjë pyetjeje

Nr. Kontaktues 044-366-111.

Bordi i Drejtorëve

Gëzim Zeka

Erlira Mullabazi

Valzon Morina

Arta Hoti

Behar Gashi



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731

► Hysen Çoçaj shpall te pavlefshme dëftesat e vitit X, XI, XII, XIII dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Ertan Vezej shpall te pavlefshme dëftesat e kl V - IX shf "Naim Frasheri" Vlashnje.

► Asllan Vezej shpall te pavlefshme dëftesat e kl V - IX shf "Naim Frasheri" Vlashnje.

► Sabuhi Nebiu shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Lirim Nebiu shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales